

# DORACAK

PËR PARANDALIMIN E DUKURIVE NEGATIVE  
NË SHKOLLA TË MESME TË LARTA



Ky doracak u hartuar nga grupi punues i themeluar me vendim të sekretarit të përgjithshëm, nr.2-458, data: 24.02.2014, me këtë përbërje:

1. Merita Jonuzi, Koordinatore për të Drejtat e Njeriut, Koordinatore e grupit;
2. Qëndresa Ibra Zariqi, Zyrtare e lartë në ZKM/ZQM, anëtare;
3. Shqipe Gashi Ramadani, Zyrtare e planprogrameve, anëtare;
4. Leonora Shala, Koordinatore për shkollat e shëndetshme, anëtare
5. Habibe Buzuku, zyrtare e trajnimeve, anëtare
6. Bislim Krasniqi, mësimsdhënës në gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë, anëtar
7. Hamdi Thaçi, mësimsdhënës në gjimnazin “Sami Frashëri ” në Prishtinë, anëtar

Ndërkaq dizajnimi dhe botimi u përkrah nga UNICEF-i, zyra në Prishtinë



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije  
Ministri of Education, Science and Technology

# DORACAK

PËR PARANDALIMIN E DUKURIVE NEGATIVE  
NË SHKOLLA TË MESME TË LARTA

Prishtinë, 2014

# Prishtinë, 2014

DORACAK PËR PARANDALIMIN E DUKURIVE  
NEGATIVE NË SHKOLLA TË MESME TË LARTA



# PËRMBAJTJA

## 1.Hyrja

### 2.Kapitulli: Roli i shkollës në parandalimin e dukurive negative

#### 2.1Kurrikulat

#### 2.2Roli i organeve të shkollës

### 3.Kapitulli: Informacione të përgjithshme mbi secilën temë:

#### 3.1Adoleshenca (ndryshimet hormonale, emocionale etj.)

#### 3.2. Rreziqet e përfshirjes së të rinjve në dukuri negative gjatë fazës së adoleshencës qëndresa

#### 3.3. Dukuritë negative që dëmtojnë zhvillimin fizik dhe intelektual të të rinjve\* përdorimi i substancave narkotike, dhuna, diskriminimi, keqpërdorimi i teknologjisë informative)

#### 3.4. Përgjegjësitë qytetare në parandalimin dhe reagimi ndaj dukurive negative

### 4. Kapitulli: Planifikimi i procesit mësimor

#### 4.1 Informata të përgjithshme për planifikim

#### 4.2Përgatitjet për orën mësimore

#### 4.3 Si realizohet një orë mësimore?

### 5. Kapitulli:Modele të orëve mësimore.

#### 5.1 Tema: Adoleshenca

#### 5.2 Tema: Rreziqet e përfshirjes së të rinjve në dukuri negative gjatë fazës së adoleshencës

#### 5.3 Tema: Dukuritë negative që dëmtojnë zhvillimin fizik dhe intelektual të të rinjve (përdorimi i substancave narkotike)

#### 5.4. Tema: Dhuna, përkufizimi dhe llojet e saj

#### 5.5. Tema: Keqpërdorimi i teknologjisë informative dhe diskriminimi

## 6.Modul trajnimi

## 7.Përfundimi

## 8.Shtojcë/ burimet e informacionit



## 1.Hyrje

Doracaku për parandalimin e dukurive negative në shkollat e mesme të larta ofron informacione të mjaftueshme mbi dukuritë negative që janë evidente në shoqërinë tonë, ndaj të cilave duhet reaguar me kohë në të gjitha nivelet e organizimit shoqëror. Roli i shkollës është i pakontestueshëm në

parandalimin e dukurive negative, prandaj ky doracak deshifron këtë rol, duke prezantuar përgjegjësitë dhe mundësitë e reagimit të secilit organ shkollor, por edhe të trajtimit të temave relevante në procesin e rregullt të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

### Rëndësia dhe qëllimi i doracakut

Doracaku didaktik është mjaft i rëndësishëm për rritjen e vetëdijesimit kundër dukurive negative (përdorimi i substancave narkotike, dhuna, diskriminimi, keqpërdorimi i teknologjisë informative), por edhe shton informacionet relevante për aspektet e adoleshencës, njohja e të cilave ndihmon stafin e shkollave dhe veçanërisht mësimdhënësit që të kenë qasje adekuate në punën e tyre me fëmijët e kësaj moshe.

Qëllimi i këtij doracaku është parandalimi i dukurive negative në shkollat e mesme të larta nëpërmjet procesit të rregullt edukativo-arsimor. Me zbatimin efikas të doracakut, mësimdhënësit mund të rrisin performancën e tyre të mësimdhënies dhe mësimnxënies, në vetëdijësimin mbi trajtimin adekuat të problemeve me të cilat ballafaqohen brenda shkollave, duke kultivuar dhe promovuar te nxënësit vlerat e qytetërimit, sjelljet e shëndosha, shmangien e situatave konfliktuale si dhe reflektimin e edukatës dhe mirësjelljes adekuate, si në klasë e shkollë, ashtu edhe jashtë: në rrugë, familje dhe shoqëri.

### Struktura

Siç shihet, doracaku në strukturën e vet përmban pjesën hyrëse, për të vazhduar më tej me rolin e shkollës në parandalimin e dukurive negative, me informacionet e përgjithshme mbi secilën temë (Adoleshenca, Rreziqet e përfshirjes së të rinjve në dukuri negative gjatë fazës së adoleshencës, Dukuritë negative që dëmtojnë zhvillimin fizik dhe intelektual të të rinjve, Përgjegjësitë qytetare në parandalim dhe reagim ndaj dukurive negative). Pas tyre vjen rrjedhshëm pjesa e planifikimit të procesit mësimor, modelet e orëve mësimore, moduli i trajnimit dhe pjesa përfundimtare e shoqëruar me shtojcën e burimeve/referencave.

Doracaku si i tillë lehtësisht mund të përdoret në kuadër të secilës fushë kurrikulare, në korrelacion me fushat kurrikulare, e pse jo edhe në kuadër të lëndëve zgjedhore dhe aktiviteteve shtesë, që mund të realizohen nga stafi arsimor i shkollave.

## KAPITULLI 2

### 2. Roli i shkollës në parandalimin e dukurive negative

Zhvillimet e mëdha në shoqëri, krahas asaj që jetën e kanë bërë më të lehtë, ato në të njëjtën kohë edhe kanë krijuar hapësira të ndryshme rrezikshmërie. Në këtë zhvillim shoqëror, fëmijët dhe të rinjtë janë ndër potencialet që më së shumti mund të jenë pre e rreziqeve të ndryshme. Gjithashtu edhe ndryshimet e vetë fëmijëve gjatë rritjes shpesh mund t'i gjejnë të dobët para situatave të ndryshme jetësore. Meqenëse ata pjesën më të madhe të kohës e kalojnë në shkollë, shkolla mund të luajë rol shumë të madh në përgatitjen e tyre që të dinë t'u ikin situatave jo të mira, por edhe në rast përballjeje të reagojnë drejt dhe të raportojnë me kohë dhe në vendin e saktë.

Funksionimi i strukturës organizative të shkollës, kurrikula fleksibile, mësimdhënia dhe të nxëniet efektiv, qoftë gjatë orëve mësimore, por edhe gjatë aktiviteteve jashtëkurrikulare (jashtëshkollore), gjithnjë në bashkëpunim me aktorët kontribues, sigurojnë përgatitjen e nxënësve për përballje me sfidat e tanishme, por edhe të së ardhmes që sjell jeta.

#### 2.1 Roli i kurrikulës

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës më 2011 ka miratuar **Kornizën e kurrikulës së Kosovës**, dokument i cili rregullon gjithë arsimin parauniversitar. Filozofia mbi të cilën është hartuar ky dokument, është zhvillimi i kompetencave për të nxëniet tërëjetësor, të cilat janë caktuar nga Bashkimi Evropian. Mbi bazën e kësaj filozofie, synimi i arsimit parauniversitar në Kosovë është përgatitja e nxënësve për të tashmen dhe të ardhmen mjaft sfiduese.

Ky dokument përcakton: Qëllimet e arsimit parauniversitar; Parimet e arsimit parauniversitar, Kompetencat kryesore të cilat duhet zhvilluar te nxënësit; Nivelet dhe nënivelet formale të arsimit parauniversitar; Fushat e kurrikulës (fushat mësimore); Kohën e nevojshme për realizimin e secilës fushë kurrikulare dhe Vlerësimin e arritjeve të nxënësve.

Më vonë, më 2012, MASHT ka hartuar tri dokumente, të cilat janë në funksion të zbatimit të Kornizës së kurrikulës së Kosovës, respektivisht Kurrikulën bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor, **Kurrikulën bërthamë për shkollën e mesme të ulët dhe Kurrikulën bërthamë për shkollën e mesme të lartë**. Mbi bazën e këtyre dokumenteve, **shkollat hartojnë vetë planprogramet, që do të thotë se shumë çështje, që shkolla së bashku me komunitetin i konsiderojnë si të nevojshme, të trajtohen për të mirën e nxënësve në favor të sigurisë dhe shëndetit të tyre, mund t'i zgjidhë pa kurrfarë problemi.**



**Cilat janë mundësitë e kurrikulës** për përgatitjen e nxënësve që t'ju ikin situatave të rrezikshme dhe devijuese për ta?

Dokumentet kurrikulare ofrojnë mundësi të shumta sa i përket përgatitjes së nxënësve që t'ju ikin situatave të rrezikshme dhe devijuese për ta.

Në qëllimet e arsimit parauniversitar, që do të thotë se i gjithë arsimit parauniversitar me tërë organizimin e vet duhet të punojë në drejtim të arritjes së tyre, vend të veçantë zë edhe Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare, dhe Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit. Kjo do të thotë se nxënësit duhet përgatitur, jo vetëm që mos t'ju ekspozohen situatave të rrezikshme të shkaktuara nga faktori njeri, por edhe ata mos të bëhen persona të cilët do ta cenojnë sigurinë dhe shëndetin e të tjerëve. Me këtë rast synohet promovimi i vlerave qytetare, përgjegjësia ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve, sepse respektohet ligji, respektohet vetja, respektohen të tjerët dhe jepet kontribut si qytetar në raportimin e këtyre çështjeve në dobi të të gjithëve.

Në parimet e arsimit parauniversitar, mbi bazën e të cilave organizohet gjithë procesi mësimor, vend të rëndësishëm zë parimi i gjithëpërfshirjes, çka do të thotë se të gjithë nxënësit duhet trajtuar barabartë në përfshirje në shkollë, por edhe në mësimdhënie dhe në nxënie. Shkolla nuk duhet të diskriminojë askënd, nuk duhet të ofendojë, nuk duhet ta përdorë dhunën ndaj askujt, por duhet respektuar dinjitetin e secilit, potencialet e secilit dhe mbi bazën e tyre duhet zhvilluar mësimdhënien dhe përkrahur të nxënit.

## Kompetencat kryesore

Në kornizën e Kurrikulës së Kosovës janë përcaktuar gjashtë kompetenca kryesore, të cilat duhet zhvilluar te secili nxënës deri në fund të arsimit parauniversitar si:

- Komunikues efektiv
- Mendimtar kreativ
- Nxënës i suksesshëm
- Kontribues produktiv
- Individ i shëndoshë
- Qytetar i përgjegjshëm

Në të gjitha këto kompetenca në njëfarë mënyre janë prezente edhe rezultatet e zhvillimit të shkathtësive të evitimit, mosshkaktimit të situatave të rrezikshme për veten dhe për të tjerët dhe gjendshmëria në situata të tilla. Por, rezultate më të theksuara për përgatitje të tillë gjejmë në kompetencat individ i shëndoshë dhe qytetar i përgjegjshëm.

**P.sh. nxënësi deri në fund të klasës së dymbëdhjetë duhet të jetë në gjendje: që në mënyrë të përgjegjshme të përdorë teknologjinë (komunikues efektiv); të gjykojë drejt, në mënyrë kritike t'i qaset informatës (mendimtar kreativ); të kërkojë këshilla, të përballet me vështirësi në mënyrë**

konstruktive, të menaxhojë konfliktet (nxënës i suksesshëm); t'i menaxhojë emocionet, stresin, traumat, t'i zgjidhë konfliktet ndërpersonale në mënyrë konstruktive, t'u përmbahet kodeve të mirësjelljes, të jetë i vetëdijshëm për pasojat e veta (individ i shëndoshë); t'i mbështesë të drejtat e njeriut, t'i ushtrojë të drejtat e veta dhe t'i respektojë të drejtat e të tjerëve, ta vlerësojë diversitetin dhe të demonstrojë tolerancë, të kontribuojë në zgjidhjen e problemeve, (qytetar i përgjegjshëm) etj.

Të gjitha këto kompetenca zhvillohen në mënyrë graduale te nxënësit nga klasa në klasë.

Në dokumentet e kurrikulave bërthamë, këto kompetenca janë zberthyer në rezultate të të nxënës për secilën shkallë kurrikulare (në nivel formal). Këto rezultate duhet të arrihen nga secili nxënës deri në fund të secilës shkallë. P.sh., deri në fund të klasës së njëmbëdhjetë (shkalla e pestë kurrikulare) nxënësi:

**Gjykon vërtetësinë e një rezultati të dhënë (p.sh. rezultatin e një detyre nga... shoqëria...), ... dhe nxjerr përfundime për vërtetësinë e gjykimit të dhënë. (Mendimtar kreativ - rezultati II.6).**

**I analizon përparësitë dhe dobësitë e veta personale, duke i evidentuar masat përmes të cilave synon ta mbështesë avancimin personal në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon t'i përmirësojë dobësitë personale. (Individ i shëndoshë - rezultati V.1).**

**Përkraan dhe shpjegon të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e individit në raste të ndryshme, si: në shtëpi, në klasë, në shkollë, në shoqëri, dallon rastet kur hyjnë në konflikt me njëri-tjetrin dhe paraqet alternativa të zgjidhjes së tyre. (Qytetar i përgjegjshëm VI.1).**

**Në fund të secilës shkallë kurrikulare mund të gjenden rezultate të këtyre natyrave të cilat arrihen nga nxënësit duke i zhvilluar njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat të cilat janë në funksion të evitimit dhe përballjes në mënyrë të drejtë me situatat e rrezikshme.**

## Fushat e kurrikulës

Në dokumentet kurrikulare janë përcaktuar shtatë fusha kurrikulare (fusha mësimore), të cilat më pas edhe ndahen në lëndë mësimore. Fushat e kurrikulës që janë përcaktuar në dokumentet kurrikulare janë:

- Gjuhët dhe komunikimi
- Artet
- Matematika
- Shkencat e natyrës
- Shoqëria dhe mjedisi
- Shëndeti dhe mirëqenia
- Jeta dhe puna

Të gjitha këto fusha kurrikulare së bashku kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave, respektivisht në arritjen e rezultateve të nxënësve për kompetencat për secilën shkallë kurrikulare, e në këtë rast edhe në arritjen e rezultateve që kanë të bëjnë me përgatitjen e nxënësve për evitimin dhe përballjen në mënyrë të drejtë me situatat e rrezikshme të shkaktuara nga faktori njeri.

Për secilën fushë kurrikulare në kurrikulat bërthamë për secilën shkallë kurrikulare janë caktuar rezultatet e të nxënësve të fushës nga të cilat nxirren përmbajtjet mësimore, të cilat duhet të jenë në funksion të vetë rezultateve të fushës kurrikulare dhe rezultateve të kompetencave.

Secila fushë kurrikulare mund të kontribuojë në trajtimin e temave të cilat i ndihmojnë nxënësit në zhvillimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të cilat janë në funksion të evitimit dhe përballjes në mënyrë të drejtë me situatat e rrezikshme, por disa fusha kurrikulare ofrojnë mundësi të shumta në këtë drejtim. Fusha Shoqëria dhe mjedisi dhe fusha Shëndeti dhe mirëqenia, ofrojnë hapësira të veçanta për trajtimin e temave në fjalë. Meqenëse mësimdhënësit mbi bazën e rezultateve të të nxënësve të fushës kurrikulare përcaktojnë përmbajtjen, ata me kompetencë të plotë mund t'i trajtojnë edhe këto tema, nëse shkolla, nxënësit, prindërit dhe komuniteti i shohin të arsyeshme.

#### **SHEMBULLI 1:**

Rezultati i shkallës së 5-të kurrikulare (klasa X dhe XI) i fushës Shoqëria dhe mjedisi thotë se: Nxënësi jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme – Përmes punës në projekte ose në aktivitete grupore analizon në mënyrë kritike dallimet ndërmjet sistemeve të vendimmarrjes në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe ndikimin e tyre në jetën e qytetarëve në rrethana dhe në periudha të ndryshme historike. Atëherë përmes lëndëve që i takojnë kësaj fushe kurrikulare mund të trajtohen sistemet e vendimmarrjes si në aspektin lokal e deri në atë të nivelit ndërkombëtar në raport me drogat, trafikimin me qenie njerëzore, keqpërdorimin e internetit, etj.

#### **SHEMBULLI 2:**

Rezultati i shkallës së 5-të kurrikulare (klasa X dhe XI) i fushës Shëndeti dhe mirëqenia: Të kuptuarit e fëmijërisë, adoleshencës, të qenit prind; ndërtimi i marrëdhënieve të hapura, udhëheqja e shëndetit seksual, thotë se nxënësi: Njih vendet se ku mund të marrë përkrahje në lidhje me situatat që përfshijnë abuzimin dhe kupton ligjet që e mbrojnë nga lloje të ndryshme të abuzimit; Zbaton njohuritë themelore lidhur me rreziqet për shëndetin seksual dhe riprodhues dukuritë dhe shprehjet negative të cilat ndikojnë në jetën e tyre dhe të bashkëmoshatarëve të tyre. Atëherë përmes lëndëve të kësaj fushe mund të trajtohen tema që kanë të bëjnë me delikuencën - jetën seksuale, rreziqet nga të pasurit marrëdhënie seksuale në mënyrë të pambrojtur, drogat, etj.

Temat që ndihmojnë parandalimin e dukurive negative, respektivisht që kanë të bëjnë me përgatitjen e nxënësve për evitimin e rreziqeve dhe mosshkaktimin e tyre edhe nga vetë ata, mund të trajtohen edhe përmes projekteve ndërkurrikulare (tema që mund të trajtohet nga të gjitha fushat/lëndët mësimore) por që kontributojnë mund të japin të gjitha fushat e kurrikulës si, p.sh. në hulumtimin e shkeljes së të drejtave të njeriut ku për temë

mund të jetë përdorimi i dhunës për arritjen e qëllimeve, mund të kontribuojnë fushat kurrikulare: gjuhët dhe komunikimi përmes mënyrës së shkrimit dhe prezantimit të hulumtimit; matematika përmes analizave matematikore të të dhënave; shëndeti dhe mirëqenia përmes trajtimit të shëndetit fizik dhe emocional; shoqëria dhe mjedisi përmes analizës së konventave të të drejtave të njeriut; jeta dhe puna përmes trajtimit të rreziqeve në punë të shkaktuara nga faktori njeri, pastaj përdorimi i teknologjisë elektronike për hulumtim dhe prezantim dhe gjithashtu rreziqet nga përdorimi i teknologjisë elektronike (facebook-ut,...), dhe përmes fushave të tjera kurrikulare etj. Temat në fjalë mund të trajtohen ose të grumbullohen edhe në mësimin me zgjedhje, por shkolla duhet të marrë mendimin nga nxënësit dhe prindërit për përzgjedhjen e tyre. Gjithashtu shkolla-mësimdhënësi duhet të hartojë kurrikulë të veçantë për këto tema dhe më pas duhet aprovuar në komunë.

Nga përshkrimi i mundësive që ofron paketa kurrikulare mund të konkludojmë se shkolla mund të trajtojë tema të ndryshme aktuale por që janë në funksion të zhvillimit të kompetencave kryesore të parapara me dokumentet kurrikulare.

## 2.2 Roli i organeve të shkollës

Shkolla është institucion i cili funksionon si rezultat i organizimit të brendshëm të saj. Ajo përbëhet prej organeve qeverisëse, përkrahëse dhe profesionale. Organet qeverisëse janë: drejtori dhe këshilli drejtues i shkollës, ndërsa këshilli i prindërve dhe këshilli i nxënësve më shumë luajnë rolin e përkrahësve. Organe profesionale janë, këshilli i arsimtarëve, këshillat e klasave (arsimtarët e lëndëve të ndryshme të klasës së njëjtë) dhe këshillat profesionale, respektivisht aktivet profesionale (mësimdhënësit e fushës së njëjtë kurrikulare/mësimore).

Rol të rëndësishëm në përkrahjen e nxënësve luajnë edhe psikologu dhe pedagogu i shkollës. Secila nga këto organe kontribuon në evitimin dhe përgatitjen e nxënësve për përballje të drejtë me sfidat jetësore. Gjithashtu ato të gjitha së bashku punojnë për të krijuar një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm si në aspektin e infrastrukturës fizike, ashtu edhe në aspektin emocional, social dhe në aspektin e zhvillimit të vlerave si të besimit në vetvete, barazisë, tolerancës, etj. Shkolla është një familje ku duhet të

funksionojë paqja, toleranca e jo dhuna dhe të gjitha sfidat duhet tejkaluar së bashku.

**Drejtori dhe këshilli drejtues i shkollës** mund të marrin vendime për trajtimin e temave për situata të rrezikshme për nxënësit, qoftë delikuencën, dhunën, drogat, rreziqet nga interneti, trafikimi i qenieve njerëzore, etj., nëse ata i konsiderojnë si emergjente çështjet eaktuara. Ata mund t'ju propozojnë mësimdhënësve trajtimin e çështjeve të tilla por edhe të marrin masa sigurie në nivel shkolle. Mund të kontribuojnë edhe në menaxhimin e brendshëm të shkollës duke i mobilizuar të gjithë aktorët brenda shkollës, duke i evituar praktikat jo të suksesshme të menaxhimit (caktimi i një apo dy kujdestarëve të ditës – arsimtarë që ndoshta mund të konsiderohet si praktikë jo shumë efektive, ndoshta mund të aplikohen qasje të tjera). Gjithashtu edhe mund të bashkëpunojnë me komunitetin për çështje të aktuara, komunën, policinë, OJQ, mjekësinë familjare, etj.

**Psikologu-ia dhe pedagogu-ia** kontributin e japin përmes kontakteve direkte me nxënës, bashkëpunimit me mësuesin, prindër, por edhe me organe kompetente profesionale, nëse çështjet kanë evoluuar dhe janë të pamundshme të zgjidhen. P.sh. mund të bashkëpunojnë me drejtorin e shkollës, bordin drejtues të shkollës, mjekët, policinë, por edhe me institucione korrektuese, punëtorë socialë, etj.

**Këshilli i nxënësve** kontribuon në përmirësimin e mjedisit mësimor, kushteve të punës dhe interesave që kanë të bëjnë me shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve.

**Këshilli i prindërve** mund t'i paraqesë ankesë drejtorit të shkollës, komunës dhe MASHT-it për cilësinë e mësimit, joefektive, për mjedisin shkollor jo të sigurt, jo të shëndetshëm, etj.

**Këshilli i arsimtarëve**, këshillat e klasave dhe aktivitetet profesionale kontribuojnë në planifikimin e aktiviteteve kurrikulare (mësimore), aktivitetet ndërkurrikulare dhe jashtëkurrikulare (jashtëshkollë), të cilat janë në funksion të zhvillimit të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave për vetëdijësimin e ekzistimit të rreziqeve të shkaktuara nga faktori njeri dhe për përballjen me sukses me sfida të tilla.

**Aktivitetet kurrikulare** (aktivitetet mësimore) realizohen përmes fushave kurrikulare (fushave mësimore), respektivisht lëndëve mësimore. Mësuesin përmes lëndëve mësimore mund të kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave të nxënësve, individit të shëndoshë dhe qytetarit përgjegjshëm.

Aktivitetet ndërkurrikulare realizohen përmes disa fushave kurrikulare dhe janë aktivitete që realizohen përmes procesit të drejtpërdrejtë mësimor, por edhe jashtëmësimor, ndërsa aktivitetet jashtëkurrikulare janë aktivitete që realizohen jashtë procesit të drejtpërdrejtë mësimor. Ato mund të jenë projekte me karaktere të ndryshme, si p.sh. fushatat për vetëdijësim për rreziqet nga çështjet dhe situatat e caktuara, pastaj projekte me karakter hulumtues, vizitat në ndonjë institucion, p.sh. polici, gjyq etj. Këtu mund të kontribuojnë të gjitha fushat kurrikulare, respektivisht të gjitha lëndët mësimore, por secila nga këndi i vet.

Për zhvillimin e aktiviteteve kurrikulare, ndërkurrikulare dhe jashtëkurrikulare mund të bashkëpunohet edhe me komunitetin, si prindër, OJQ, policinë etj.

Bashkëpunimi i të gjitha këtyre organeve konsiderohet si domosdoshmëri e funksionimit të një shkolle që zhvillon vlera dhe përgatit qytetarë që të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e së tashmes dhe të së ardhmes. Bashkëpunimin nuk duhet lënë spontanitetit, por ai duhet të jetë pjesë e planifikimit të aktiviteteve të secilit organ që funksionon në shkollë.

## KAPITULLI 3

### Informacione të përgjithshme mbi secilën temë

#### 3.1. Adoleshenca

Edhe sot e kësaj dite, studiuesit nuk kanë arritur të jenë në një mendje për kohën se kur fillon dhe mbaron adoleshenca. Kjo kohë luhetet nga 11 vjeç për femra dhe 13 për meshkuj, respektivisht nga 18 deri në 21 vjeç. Fjala “adoleshencë” rrjedh nga latinishtja “adolescere”, që do të thotë “pjekuri, të bëhesh i pjekur, I matur”, që njihet si fazë e zhvillimit fizik dhe mendor të njeriut, zakonisht e renditur ndërmjet fazës së fëmijërisë dhe pjekurisë ligjore (mosha madhore). Kuptimi i plotë i adoleshencës në shoqërinë e sotme mundësohet nga njohuritë që rrjedhin nga perspektiva e psikologjisë, biologjisë, historisë, sociologjisë, edukimit, dhe antropologjisë. Në kuptimin e vërtetë të fjalës, shikuar nga të gjitha këto fusha, adoleshenca është konkluduar si transicion, ndërmjet varësisë dhe pavarësisë, që përfundon kur individi arrin moshën e rritur. Moshë kjo e karakterizuar si moshë e bukurisë, e çiltërsisë, e pastërtisë, e zhvillimit, e guximit, dinamizmit dhe shpresave të mëdha, e që njëherësh shoqërohet me ndryshime rrënjësore, të cilat kanë të bëjnë jo vetëm me rritjen biologjike, por edhe me zhvillimin mendor, sjelljen, komunikimin etj. Ndryshe nga periudha e latencës, kjo moshë karakterizohet nga ndryshime themelore në të gjithë zhvillimin e fëmijës. Këtu arrihet pjekuria biologjike, e cila çon më pas në atë seksuale. Ndodhin ndryshime të mëdha edhe në funksionimin intelektual. Kalohet nga faza e të menduarit operacional konkret në atë të të menduarit logjik formal. Ndryshimet më të mëdha ndodhin në fushën emocionale e shoqërore. Në këtë moshë adoleshenti është në kërkim të identitetit të vet personal. Kjo kërkesë përbën shpesh një burim konflikti midis adoleshentit dhe prindërve. Adoleshenca shoqërohet shpesh me kriza emocionale,

të cilat çojnë drejt alkoolit, drogës, shturjes seksuale, sjelljeve vandaliste, dhunës, që më pas sjellin pasojat tepër të rënda për të ardhmen. Problemet që ndeshen në adoleshencë ndryshojnë nga ato të fazave të mëparshme. Pjekuria seksuale çon në rrethana konfliktuoze. Është e domosdoshme që adoleshenti të pajiset me të gjitha njohuritë mbi seksualitetin, mjetet kontraceptive dhe rrezikun e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme. Në këtë periudhë adoleshentët marrin përsipër më shumë përgjegjësi, organizojnë aftësitë dhe marrin vendime lidhur me zgjedhjen e profesionit të tyre. Ata fitojnë më shumë aftësi për t’iu përshtatur rregullave të vendosura nga shoqëria. Adoleshentët kërkojnë të mbështeten dhe të mirëkuptohen nga të rriturit.

Vëmendja në këtë kohë drejtohet më tepër te trupi, te pamja e jashtme, te përshtypja që u lihet të tjerëve, te pranimit ose jo i tyre. Prandaj Piazhe e karakterizon këtë veprimtari si proces ku fëmija zbulon kontratën e tij shoqërore. Në këtë mënyrë, individi, jo vetëm vendos raporte me realitetin në të cilin jeton, por ndërgjegjësohet për atë që në të vërtetë duhet të bëjë e duhet të jetë. Në gjithë këtë proces, roli i familjes dhe shkollës është parësor. Në këtë fazë zhvillimi, krijimi i stereotipeve të gabuara krijon vështirësi për marrjen e përgjegjësive, të cilat rriten në mënyrë të përshkallëzuar së bashku me fëmijën. Prandaj metodat e edukimit familjar dhe arsimor, orientimi, komunikimi dhe parimet e organizimit të punës konkrete kërkohet të përshtaten e të modelohen me veçoritë individuale të secilit fëmijë. Mbi këtë bazë realizohet në mënyrë të natyrshme dhe pa sforcime kontrata me realitetin shoqëror, e cila zgjerohet çdo ditë.



## Zhvillimi emocional

Përgjatë këtij stadi, adoleshentët ndeshen me problemin e identitetit personal, me pyetjen “Kush jam unë?”. Mund t'i imitojnë të tjerët, përfshirë prindërit, shokët, mësuesit, etj. Nëse, sjelljet që imitojnë konfliktuajnë ose janë kontradiktore, mund të përjetojnë krizë “krizë të identitetit” dhe si pasojë e kësaj modifikojnë ose braktisin imitimet e tyre. Prandaj, në këtë stad adoleshentët duhet të fillojnë të vendosin se çfarë dëshirojnë të bëjnë në jetë. Adoleshentët që arrijnë ta ndërtojnë identitetin e vet, dinë si t'i përgjigjen pyetjes se “Kush jam unë”. Për dallim nga të tjerët që nuk kanë arritur ta gjejnë këtë përgjigje, ata/ato ndjehen persona të vetëpranuar, të sigurt, të kënaqur nga puna dhe sukseset e veta, ndjehen të plotë, marrin vendime dhe dinë nga shkojnë në jetë.

Konfuzioni i identitetit karakterizohet me tendosje disponimi depresiv, vetëvlerësim dhe vetëbesim i ulët, frikë, dhimbje, pikëllim, tërheqje sociale, etj., që ndikon në çrrugullimin social të adoleshentit. Derisa personi i ri tenton që shpejt t'i zgjidh emocionet negative, gjasat që të kërkojë shkarkim dhe të përfshihet në dukuri negative përgjatë krizës së përcaktimit të identitetit janë të larta. Përfshirë, përdorimin e alkoolit ose drogës; ikja nga orët e mësimit, lëshimi i shkollës, ikja nga shtëpia dhe endja poshtë e lartë; paraqitja e sjelljeve socio-patologjike që karakterizohen me vandalizëm, maltretim të moshatarëve, anëtarëve të familjes, arsimtarëve dhe bashkëqytetarëve të tjerë nga mesi ku jetojnë. Megjithatë, jo çdoherë kriza manifestohet me sjellje psikopatologjike, veçanërisht nëse individ arrin vetë me sukses ta tejkalojë krizën ose me ndihmën e të tjerëve. Deri tani, jeta e fëmijës është sjell kryesisht rreth familjes. Ndërsa, adoleshenca e ka efektin e gurit të gjuajtur në ujë, sepse rrethi i saj social hapet për të përfshirë miqësi me anëtarët e gjinisë së njëjtë, të gjinisë së kundërt, grupeve të ndryshme sociale dhe etnike si dhe të rritur të tjerë, si mësues të preferuar ose trajnerë. Përdërisa, meshkujt më shumë e zhvillojnë shoqërinë përmes aktiviteteve të përbashkëta, femrat mund ta zhvillojnë më tepër shoqërinë përmes komunikimeve verbale.

Përfundimisht të rinjtë zhvillojnë kapacitetin për të rënë në dashuri dhe formimin e marrëdhënieve romantike. Adoleshenca vlerësohet edhe si moshë e revoltës, e shpërthimeve apo e konflikteve të brendshme e të jashtme, të shprehura ose të heshtura, të cilat ndodhin për shkaqe objektive dhe subjektive. Pjesë përbërëse e adoleshentit janë ndryshimet e vullshme të humorit, zhvillimi i nevojës për individualizëm dhe pavarësi, në këtë moshë krijohet një përfytyrim fillestar për orientimin profesional, gjë e cila krijon një tendosje e frikë, pavarësisht nga zgjedhjet që mund të bëhen. Këto dhe shumë ndryshime të tjera të vullshme gjatë zhvillimit të adoleshentit janë proces normal i pjekurisë.

Jo të gjithë të rinjtë hyjnë dhe dalin nga adoleshenca në të njëjtën moshë ose shfaqin këto sjellje të njëjta. Për më tepër, përgjatë adoleshencës, një i ri mund të jetë shumë më larg në disa faza të zhvillimit sesa të tjerët. Për shembull, një vajzë 16 vjeçare mund t'i ngjajë një të riu të rritur, por ajo ende mund të veprojë si fëmijë pasi nuk është në fund të adoleshencës kur zhvillimi intelektual, emocional dhe social fillojnë të përshtaten me zhvillimin fizik.



## 3.2. Rreziqet e përfshirjes së të rinjve në dukuri negative gjatë fazës së adoleshencës

Adoleshenca përfaqëson një kohë kalimtare nga fëmijëria në pjekurinë relative. Porsa nxënësit hyjnë në moshën e adoleshencës, ata pësojnë ndryshime dramatike. Kjo është një moshë kritike ndryshimesh dhe përjetimesh, prandaj ndikimi i faktorëve shoqërorë në të është shumë i rëndësishëm. Kohëzgjatja e adoleshencës mund të mos korrespondojë e njëjtë për të gjithë njerëzit për sa u takon karakteristikave të tyre të ndryshme të zhvillimit.

Gjatë kësaj faze, fëmija do t'i përdorë çdo ditë të gjitha shkathtësitë dhe aftësitë në mënyrë të pavarur, ndjeshmëria emocionale e tyre është e lartë. Tanimë adoleshentët janë të aftë të komunikojnë pothuajse për çdo gjë, mund të japin ide të reja, t'i zhvillojnë idetë e veta në mënyrë të pavarur dhe të krijojnë shtegun e tyre. Përderisa, ritmet e zhvillimit janë të larta, në planin e formimit të personalitetit ka paqëndrueshmëri të madhe. Ngase, shfaqen dyzime e lëkundje në karakter, dashurojnë vullshëm dhe urrejnë papritmas, binden, nënshtrohen, por edhe rebelohen, paraqiten të sjellshëm e idealistë, por edhe brutalë e materialistë.

Ata manifestojnë gjendje të ngritur emocionale dhe pa u kuptuar shndërrohen në pesimistë e kokëfortë, jo rrallë hutohen, përfshihen nga ndjenja e të qenit i pavlefshëm, duke ndikuar kështu në mbylljen në vetvete.

Në këtë fazë, adoleshentët eksperimentojnë me të gjitha llojet e mundësive gjatë përpjekjeve për të kuptuar se kush është në të vërtetë dhe ta kuptojë identitetin e vet unik. Kanë shtytje të fuqishme për të shprehur se kush janë në të vërtetë dhe jo se si të

tjerët presin që të jenë. Kur adoleshentët formojnë ndjenjën e identitetit përqipen shumë të fitojnë më tepër pavarësi. Sa më tepër të rinjtë fitojnë pavarësi nga të rriturit, aq më shumë kërkojnë ta plotësojnë këtë me mbështetjen te bashkëmoshatarët. Përjetimet romantike luajnë një rol të madh për formimin e personalitetit dhe vetë afirmimin e rritjes, e cila kushtëzohet edhe nga nevoja për plotësim. Prireja për të siguruar sa më shumë shokë rreth vetes, është e lidhur me pasigurinë dhe frikën ndaj vetmisë. Shokët e lojës në këtë kohë bëhen tepër të afërt, me të cilët realizohet imitimi dhe krahasimi. Në lidhjet shoqërore ka intensitet, emocion deri edhe pasione, të cilat pengojnë njohjen reale të cilësive të bashkëmoshatarëve.

Mbi këto linja formohen grupe adoleshentësh me rregulla të brendshme të përcaktuara, me qëllime e aspirata të përbashkëta. Shoqërimi i vazhdueshëm i adoleshentëve në grupe, megjithëse në disa raste nxit sjelljet kundër rregullave, është i një rëndësie të pazëvendësueshme për zhvillimin e përshkallëzuar e të gjithanshëm të personalitetit të tyre. Ambicia e konkurrenca ndërmjet pjesëtarëve të grupit luan rol motivues. Andaj, me mjaft vlerë janë debatet rreth njohurive të marra në shkollë, diskutimet rreth filmave, librave, veprimtarive të ndryshme etj.

Por veprimtaria e një grupi të caktuar adoleshentësh në raste të caktuara mund të kalojë në sjellje jonormale. Adoleshentët në të tilla raste mund të shfaqin sjellje që shoqëria i dënon, si: largimi nga orët e mësimin ose nga shkolla, përfshirja në akte të dënueshme, përdorimi a trafikimi i lëndëve narkotike etj.

Apo sjellje të influencuara nga grupi, duke e shprehur vetveten nëpërmjet ndryshimeve të papritura në përzgjedhje të muzikës, veshjes, frizurës, bindjeve, preferencave në ushqim, aktivitetet e jashtëshkollore, planeve për të ardhmen.

Pothuajse çdo adoleshent has në disa vështirësi që kanë lidhje me identitetin, vetëdijen, kontrollin prindëror, konformizmin ndaj normave shoqërore etj. Të rinjtë kanë dëshirë, veçanërisht gjatë viteve të shkollës së mesme, të jenë gjithnjë më të pavarur. Kjo vërehet në veshjen e tyre, në pjesëmarrjen në diskutime, në mendimet e vlerësimet që shfaqin, në teknikat që përdorin për zgjidhjen e problemeve. Ata janë të shqetësuar se çfarë thonë e mendojnë të tjerët për ta. Të gjitha këto krijojnë një periudhë stuhie, trazirash dhe stresi, të cilat, veç të tjerash, rrjedhin edhe nga prirja për t'i zgjidhur të gjitha gjërat përnjëherë.

Por, adoleshentet e kanë vështirë ta kuptojnë se mund t'u ndodhin gjëra të këqija, ende nuk kuptojnë plotësisht se mund të lëndohen, mund të mbesin shtatzëna, ose se mund të vdesin. Ndonjëherë, ato bëjnë gjëra shumë të rrezikshme sepse mendojnë se atyre nuk do t'u ndodhë asnjë e keqe.

Duke mos i pasur njohuritë e duhura për rreziqet dhe pasojat e tyre, adoleshentët eksperimentojnë me gjëra të rrezikshme, përfshirë eksperimentimin me droga, alkool, duhan, abuzime me teknologji informative, përfshirë eksperimentimin në seks dhe marrëdhënie. Jo në pak raste adoleshentët që dështojnë, manifestojnë akte brutaliteti e vandalizmi, përplasje me ligjin. Reagimet e tilla të rënda amortizohen me marrëdhënie të ngrohta, me shprehje të besimit reciprok, me qëndrime dashamirëse, me respekt duke shmangur vërejtjet, britmat dhe ironinë. E përgjithshmeja pozitive e kësaj

zgjidhjeje është që aftësitë individuale të adoleshentit të kanalizohen në drejtimin e duhur, me synim që të ruhet dhe zhvillohet në mënyrë të shëndetshme personaliteti dhe e ardhmja e tyre.

Ka shumë raste, që prindërit nga frika ndaj ndikimit prej këtyre dukurive, t'i izolojnë fëmijët, gjë që sjell pasoja më të dëmshme, sepse kështu frenojnë zhvillimin e tyre shoqëror. Mirëpo, ndjenjat e papërshtatshmërisë vetjake dhe të inferioritetit, adoleshenti mund t'i kompensojë me agresivitet, destruktivitet, kundërshtim ndaj autoritetit dhe qëndrim armiqësor ndaj shoqërisë. Shumica e tyre gjykojnë se një qasje adekuate ndaj manifestimeve agresive është reagimi me të njëjtën masë – me agresivitet dhe të vetmin mjet për t'iu kundërvënë e shikojnë te ndëshkimi. Pikërisht mosnjohja e duhur e natyrës së agresivitetit bën që të rriturit me veprimet e tyre, në vend që të kontrollojnë agresivitetin te të rinjtë - ose përkohësisht e frenojnë manifestimin e tyre ose akoma më tepër e intensifikojnë.

Disa të rritur nuk janë të vetëdijshëm se fenomeni i agresivitetit te të rinjtë është mjaft subtil dhe pjesë e pashmangshme e zhvillimit, prandaj çdo pakujdes në trajtimin e këtij fenomeni mund të ketë konsekuenca të dhimbshme. Shpesh ndodh që moszgjidhja e drejtë e konflikteve mes të rinjve dhe të rriturve, të gjenerojë një varg konfliktesh sekondare, të cilat mund të lënë pasoja të paparashikueshme për të dyja palët. Kështu rritet murri i mosbesimit dhe mostoleranca reciproke.

Janë djemtë ata që krijojnë alarm me veprimet e tyre të papritura kundër normave e kundër autoriteteve në familje, në shkollë e bashkësi. Situata e vuajtjeve të djemve shprehet nëpërmjet veprimeve, kundërshtimeve dhe aksioneve të përditshme. Vajzat vuajnë në heshtje e vetmi, fshihen në dhimbjet e tyre. Prandaj ato i mbajnë dhe i përjetojnë më tepër së brendshmi këto dukuri.

Prandaj me të drejtë nga shumë studiues adoleshencë është përcaktuar si moshë e cila shoqërohet me probleme tepër të ndjeshme. Sidoqoftë, kjo është koha më vendimtare kur fillojnë të testohen vetëbesimi, aftësia për vendimmarrje, aftësitë komunikative, vetërespekti, empatia, dhe aftësitë për zgjidhjen e konflikteve të cilat adoleshenti i ka mësuar.

Në mënyrë që adoleshentët mos të bien pre/viktimë e përfshirjes së tyre në dukuri negative, tani është koha kur më së shumti kanë nevojë të trajtohen me respekt, butësi dhe dashuri, duke i edukuar dhe këshilluar drejt, ofruar informata të qarta dhe të sinqerta. Andaj, vlerësimi i anëve pozitive, krijimi i besimit në aftësitë dhe mundësitë që kanë të rinjtë, krijojnë kushte reale për të ndërtuar projektin e suksesshëm edukativ. Të rinjtë që kanë vlerësim të tepruar në shkollë apo familje, pa baza e arritje konkrete, rrezikohen të shndërrohen në idhuj të rremë. Baraspesha e kërkesave, kritikave e vërejtjeve me vlerësimet dhe vetëvlerësimet kërkohet të ruajnë raporte që të shërbejnë për nxitje e motivim të mëtejshëm.

Nuk duhet harruar se “besimi” në fazën e adoleshencës është jashtëzakonisht i rëndësishëm, prandaj atyre duhet t’ju dëshmohet ky besim në mënyrë që kurdo që kanë nevojë, ta dinë se e kanë një vend ku mund të drejtohen për të pranuar përkrahjen e nevojshme, e assesi të ushtrohet kontroll mbi ta. Pra, zhvillimi i personalitetit të adoleshentit është një dukuri komplekse, që mund të përsoset, po të ketë një qëndrim me përgjegjësi të lartë nga ana e mësuesve dhe prindërve, të cilëve për t’ia dalë mbanë, u duhet edhe njëfarë formimi i mjaftueshëm socio-psikologjik. Edhe adoleshentët janë njerëz, prandaj bëjnë gabime.

Ndonjëherë, në përpjekjet e tyre për të bërë zgjedhje

të pavarura, do të bëjnë gabime, përderisa bëjnë përpjekje për të mësuar më shumë për jetën, mund të lëndohen.

Andaj, është më se e rëndësishme që mësimdhënia të zhvillohet mbi bazën e parimeve dhe metodave bashkëkohore të edukimit, të cilat na lejojnë dhe na ndihmojnë për të respektuar zhvillimin e individualizuar dhe efektiv të çdo fëmije. Kjo do të ndikonte që mësimdhënësi të ketë njohuri mbi shkaqet se pse adoleshentët sillen në mënyrë të caktuar dhe se si t’i qaset çështjes në mënyrë pozitive, duke u bazuar në ato sjellje. Frustrimi që shkakton sjellja përkatëse e adoleshentit dhe mungesa e shkathtësive për ta menaxhuar atë, i bën disa mësimdhënës të shpërthejnë në inat ndaj nxënësve të tyre dhe të përdorin ndëshkim trupor apo forma poshtëruese të ndëshkimit emocional. Mirëpo, shumë herë adoleshentët sillen kundrejt normave, ngase e ndjejnë se nuk janë duke iu plotësuar nevojat, përfshirë edhe nevojën për vëmendje. Përderisa, ndëshkimi nuk është treguar se është efektiv, veçanërisht në aspektin afatgjatë. Ndëshkimi mund t’ju shkaktojë adoleshentëve ndjenjën e turpërimit, fajit, ankthit, agresivitetit, mungesës së pavarësisë, dhe mungesës së kujdesit për të tjerët, duke shkaktuar në këtë mënyrë probleme më të mëdha për mësimdhënësit, kujdestarët dhe fëmijët e tjerë. Andaj, përdorja e teknikave disiplinuese nga mësimdhënësi ndikon që adoleshentët të mësojnë sjellje të reja, korrekte dhe pa frikë nga dhuna.

Shoqëria dhe familja janë përgjegjëse për edukimin e fëmijëve të tyre. Ato nderohen ose turpërohen nga prodhimi që nxjerrin në dritë.

### 3.4. Dukuritë negative që dëmtojnë zhvillimin fizik dhe intelektual të të rinjve

**(Përdorimi i substancave narkotike, dhuna, diskriminimi, keqpërdorimi i teknologjisë informative)**

#### Përdorimi i substancave narkotike

Republika e Kosovës është e njohur si një ndër vendet me popullatën më të re në Evropë. Edhe pse nuk kemi të dhëna të sakta mbi numrin e fëmijëve dhe personave të moshës së re, mendohet se Kosova ka popullatën më të re në Evropë, dhe sipas vlerësimeve të programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), gjysma e popullatës është nën moshën 25 vjeçare, kurse 21% e banorëve të saj janë të moshës 16 dhe 25 vjeç. Po ashtu shkalla e papunësisë në Kosovë është e lartë, posaçërisht te të rinjtë. Duhet llogaritur po ashtu se shoqëria jonë është duke e kaluar fazën më të vështirë të këtij transicioni, dhe kjo ka rezultuar me shfaqjen dhe përhapjen e dukurive negative. Kjo ka bërë që edhe Kosova, e cila në vitet 68 radhitej si një ndër vendet me rini të shëndoshë, në fillim të viteve 1999 me ndryshimet transicionale të radhitet në mesin e vendeve evropiane, ku dukuritë negative janë shfaqur dhe janë evidente në shoqërinë kosovare.

Në kuptimin gjithëpërfshirës, sipas dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës kundër drogave dhe planit të Veprimit, drogat paraqesin materie psiko-aktive, të cilat po qe se përdoren nga ana e personit kanë aftësi që ta ndryshojnë dhe dëmtojnë seriozisht integritetin psiko-fizik të personit i cili i përdorë, përkatësisht i keqpërdorë ato.

Kjo Strategji Kombëtare nga Qeveria e Kosovës, pjesë e definimit të së cilës ishte edhe MASHT, e obligon për të ndërmarrë veprime konkrete në fushën e parandalimit dhe luftimit të kësaj dukurie negative dhe të rrezikshme për vendin tonë. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë merr pjesë në parandalimin e drogave, përmes programeve të rregullta, duke i realizuar objektivat e shëndetit publik nëpërmjet aktiviteteve shkollore dhe jashtëshkollore, në të cilat aktivitetet mund të kryhen prindërit dhe komuniteti në përgjithësi.

MASHT-i në kuadër të programeve shumësektoriale, siç është programi Shkollat promovuese të shëndetit, synon ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të fëmijëve në shkolla. Objektivi i shkollave promovuese të shëndetit është që të përkrahen shkollat dhe të zhvillojë politika e programe efektive, që do të përforcojnë dhe do t'i bëjnë të shëndetshme dhe të qëndrueshme mjediset në të cilat zbatohen politikat.

Me përdorim të drogave nënkuptojmë personin, i cili si rezultat i konsumimit të drogave ka varësi fiziologjike, fizike dhe psikike ndaj tyre.

Me keqpërdorim të drogave nënkuptojmë: kryerjen e veprimtarisë së shitjes, posedimit, blerjes, prodhimit, eksportimit, transportimit, kultivimit, përpunimit, shpërndarjes së drogave në kundërshtim me Ligjin për barnat narkotike, substanca psikotrope dhe prekursorë dhe Kodin Penal të Kosovës.

Keqpërdorimi me droga është problem i madh shoqëror dhe shëndetësor në mbarë botën, ngase pasojat që dalin nga efektet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta nga kjo dukuri, janë shumëfish të dëmshme për vetë personin, familjen dhe shoqërinë në tërësi, si dhe ndikon në rrezikimin e sigurisë shtetërore. Megjithatë abuzimi me drogën është theksuar që në krye si faktor me rrezikshmëri të madhe, shqetësimet lidhur me përdorimin e drogës në mesin e kosovarëve të rinj po rriten.

Shumë lloje të drogës, siç janë: mariuana, hashishi, ekstaza, LDD, drogat e përshkruara, kokaina dhe heroina, mund të gjenden edhe në Kosovë.

Sipas Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë, departament ky që operon brenda Policisë së Kosovës, d.m.th. Ministria e Punëve të Brendshme, drogat që janë në qarkullim dhe ato që dominojnë më shumë janë kanabisi, heroina, e në sasi të vogël edhe kokaina.

## Përkufizimi i drogës

Drogë - Qohen të gjitha ato substanca që veprojnë në sistemin nervor qendror të njeriut, tjetërsojnë sjelljen e tij, japin fenomenin e tolerancës si dhe krijojnë vartësi fizike dhe psikike.

Vartësia fizike - Një gjendje fiziologjike e trupit që ndodh te përdoruesit e rregullt. Personi duhet të vazhdojë marrjen e drogës në mënyrë që t'i shmangë çrregullimet fizike që sjell mungesa e kësaj droge.

Vartësia psikologjike - Gjendja në të cilën përdoruesi arrin në konkluzionin se nuk mund t'i bëjë ballë jetës, përveçse me marrjen e drogës.

## Drogat ilegale

Koncepti i cilësdo drogë ilegale përfshin mariuanën, hashashin, amfetaminën, kokainën, krekun, ekstazinë, LSD-në apo drogat e tjera halucinatave dhe heroinën.

Ne vazhdim po e japin përshkrimin e disa nga drogat më të shpeshta në bazë të të dhënave nga policia e Kosovës, të cilat gjenden në sasi të vogla edhe në Kosovë.

## Kanabisi

Prodhet nga këрпи indian (mariuana). Përdoruesit e tij kanë halucinacione, janë nervozë, qajnë. Edhe pse kanabisi nuk shkakton vartësi fizike, mund të shkaktojë probleme në kontrollin e përdorimit. Simptomat e ndërprerjes së përdorimit të drogës nuk shfaqen pas ndërprerjes së konsumimit të tij.

Kanabisi mund të krijojë probleme themelore mendore, psikozë të fshehtë. Nuk preferohet ngasja e veturës nën ndikimin e kanabisit, sepse për shkak të refleksive të ngadalësuara mund të shkaktohen aksidente. Është shumë i rrezikshëm, posaçërisht për përdoruesit e rinj, për shkak të efekteve psikike dhe për arsye se shpie në ndërprerjen e shkollimit dhe çrregullime psikike.

## Heroina

Është substancë që prodhohet nga hashashi i opiumit. Shitet në formë të pluhurit me ngjyrë të bardhë, ose bojëkafe ose si substancë e zezë e ngjitshme. Përdoruesit kanë rrjedhje të hundës, djersitje, ethe, dhembje në eshtra, dhembje të ekstremiteteve dhe dëshirë të madhe për drogë. Heroina zakonisht injektohet, thithet nga hunda ose tymoset si cigare. Heroina që merret me injektim është mënyra më e rrezikshme e përdorimit. Përdoruesit e heroinës rrezikohen të marrin HIV, hepatitin B dhe C dhe sëmundje të tjera infektive. Abuzuesit e drogës mund të infektohen me këto sëmundje nga shkëmbimi dhe ripërdorimi i shiringave si dhe pajisjeve të tjera të injektimit (pambukut dhe lugës nga persona të infektuar). Gjithashtu përdoruesit mund të infektohen me HIV ose hepatitin C (që ka më pak mundësi) nëpërmjet marrëdhënieve seksuale të pambrojtura me një person të infektuar.

## Kokaina

Kokaina është pluhur i bardhë që del nga gjethet e bimës “coca” të Amerikës Jugore. Kjo klasifikohet në drogat simultane që përkohësisht japin iluzionin e një energjie dhe fuqie të pakufishme dhe që pas mbarimit të efektit e lënë përdoruesin në një gjendje depresive, të errët dhe tunduese për të marrë dozën tjetër. Kreku është forma e tymosjes së kokainës të ndryshuar kimikisht. Si kokaina, edhe kreku shpijnë në vartësi të shkallës së lartë.

## Hulumtimi ESPAD

### **(Hulumtimi evropian në shkolla mbi përdorimin e alkoolit dhe drogave)**

Në vitin 2011 me lejen e grupit ndërministror për shkollat promovuese të shëndetit MASHT, është aprovuar projekti “Hulumtimi evropian në shkolla mbi përdorimin e alkoolit dhe drogave. Qëllimi kryesor i projektit ESPAD ishte mbledhja e të dhënave të krahasueshme në përdorimin e substancave në mesin e nxënësve në Evropë. Në Kosovë grupi i synuar ishin nxënësit e lindur në vitin 1995, pra moshat 15–16 vjeç. Duhet theksuar se Kosova po merr pjesë në hulumtimin ESPAD për herë të parë dhe EMDCA (Qendra Evropiane për Monitorimin e Drogave dhe Vartësive nga Drogat) ka mbështetur financiarisht dhe profesionalisht studimin. Në Kosovë të dhënat janë mbledhur me administrim grupor pyetësorësh. Nxënësit janë përgjigjur në mënyrë anonime, duke iu përgjigjur pyetësorëve në klasë me asistent hulumtues, që funksiononin si udhëheqës të anketimit.

Kjo përmbledhje prezanton rezultatet e hulumtimit të vitit 2011 për Kosovën, duke ndjekur kryesisht të njëjtën strukturë të raportit ESPAD nga studimi 2007.

Bazuar në rezultatet e studimit, del se përdorimi i raportuar për cilëndo nga drogat ilegale në mesin e nxënësve kosovarë është rreth 7%, që është shumë më i ulët se mesatarja e ESPAD-it, me 20%.

Në bazë të rezultateve të hulumtimit sa i përket konsumimit të alkoolit, edhe mesatarja e konsumimit të alkoolit të nxënësit kosovarë është shumë më e ulët se mesatarja e shteteve të ESPAD-it (2007).

Proporcioni i të rinjve që kishin provuar cigaren në moshën 13 vjeçare në Kosovë ishte 18%. Në këtë mënyrë mesatarja në Kosovë është ende më e ulët sesa mesatarja e të gjitha vendeve të përfshira në ESPAD 2007.

Përafërsisht 4.5 % e nxënësve raportuan se kanë filluar ta konsumojnë duhanin në baza ditore në moshën 13 vjeçare apo në moshë të re. Kjo përqindje të djemtë ishte 7% , ndërsa të vajzat 3%.

Një qëllim tjetër i rëndësishëm i këtij projekti ishte edhe monitorimi i trendeve mbi përdorimin e substancave në mesin e nxënësve në Evropë dhe t'i krahasojë ato mes shteteve dhe grupeve të shteteve. Njohuritë e fituara në këtë mënyrë do të jenë të rëndësishme për të ardhmen, sepse këto trende do të ofrojnë bazë për iniciativa parandalimi në të ardhmen.

## Duhani

Duhani – është materie e cila përmban më shumë se 4000 substanca helmuese si nikotinë, monoksid karboni, metale të rënda. Nikotina është drogë e fuqishme që shkakton varshmëri, e cila gjendet në duhan. Përdorimi i duhanit mund të shkaktojë kancerin, sëmundjet e zemrës, çrregullime të gjumit dhe të humorit. Duhani s'është i dëmshëm vetëm për shëndetin e personave, por edhe për xhepin e tyre. Posaçërisht shtatzënat, personat me sëmundje kronike, fëmijët, të rinjtë, sportistët nuk guxojnë ta konsumojnë duhanin.

Edhe rreziqet e duhanpirjes pasive janë mirë të njohura. Të dhënat tregojnë se shëndeti i adoleshentëve në Kosovë, i atyre që janë duhanpirës aktualë dhe atyre që kurrë nuk e kishin pirë duhanin, është i rrezikuar si pasojë e ekspozimit në tymin e duhanit në ambientet si në shtëpi, ashtu edhe në vendet publike.

Në bazë të hulumtimit ESPAD (Hulumtimi evropian në shkolla mbi përdorimin e alkoolit dhe drogave sa i përket moshës së fillimit të konsumimit të drogave, citoj se të rinjtë mund ta kenë provuar pirjen e duhanit herët në jetë dhe disa prej atyre që e provuan, e vazhduan atë në konsumim të përhershëm, ndërsa të tjerët nuk e vazhduan fare.

## Alkooli

Abuzimi me alkool shkakton pasoja për shëndetin, probleme sociale, ose të dyja bashkë. Varësia nga alkooli (alkoolizmi), është një sëmundje e karakterizuar nga nevoja anormale për alkool që çon në prishje të kontrollit mbi të pirit. Edhe alkooli është helm. Alkooli shkatërron mëlçinë, lukthin dhe miliona qeliza trunore . Veprimet e

<sup>1</sup>Hulumtimi evropian në shkolla mbi përdorimin e alkoolit dhe drogave (ESPAD) është realizuar në vitin 2011 në 42 shkolla, 40 publike dhe 2 private në komunat: Prishtinë, Podujevë, Fushë-Kosovë, Suharekë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Rahovec, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Skenderaj, Klinë, Vushtrri, Viti.

të dehur janë të paparashikueshme. Personat që e konsumojnë alkoolin, e shkatërrojnë edhe veten edhe rrethin e vet. Edhe pse pirja e alkoolit shkakton varshmëri dhe për çdo vit shpenzohen miliona për trajtimin edhe për sëmundjet që lidhen me të siç janë: dëmtimi i mëlgjisë, ndalja e punës së zemrës, problemet me barkun dhe ulcerën.

## Alkooli

ndryshon sjelljen, dhe ata që pinë shumë alkool mund të bëhen agresivë dhe ka gjasa më të mëdha që të fillojnë grindje. Alkooli gjithashtu mund të ketë ndikim në trurin tonë, ashtu që mund të harrojmë se ç'kemi bërë. Personat e dehur shpesh janë agresivë, të zhurmsëm, mbajnë erë goje, sepse kanë konsumuar shumë drogë të llojit alkool.

## Statusi ligjor

Është joligjore t'ju shitet alkooli të rinjve nën moshën 18 vjeçare. Nëse tentohet të vozitet në gjendje të dehur duke pasur një përqindje të alkoolit në gjak, atëherë sanksionohet me dënime konform ligjeve në fuqi, përfshirë edhe dënimin e mundur me burg.

## E rëndësishme për prindërit

Prindërit duhet ta analizojnë relacionin brenda familjes duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve të tyre. Dinamika e jetës, mbikëqyrja e dobët e prindërve ndaj sjelljeve të fëmijëve, besimi i lartë ndaj fëmijëve, janë shkaqet më të shpeshta që shpijnë te kontakti i hershëm i fëmijëve me drogat.

Prandaj është e rëndësishme që prindërit të ndajnë kohë për fëmijët e tyre, në mënyrë që t'i zbulojnë me kohë devijimet eventuale të tyre. Shenjat më të shpeshta, të cilat mund t'i vërejnë prindërit se diçka s'është në rregull me fëmijët e tyre janë: ndryshimi i sjelljeve, çrregullime në respektim të autoritetit (prindit, arsimtarit, më të vjetrit), telefonatat e shpeshta dhe pa kohë, daljet e shkurtra dhe të shpeshta, ndërrimi i sjelljeve pas daljes, sjelljet e

rrezikshme për jetë (si ngasja e shpejtë e veturës, motoçikletës, ndërrime në veshmbathje, tatuazhi, shpimi i veshëve apo hundës, interesimi dhe mbajtja e mjeteve të çuditshme, që s'i ka pasur më parë si: shkrepëse, shishe për pika të hundës apo të syrit, injeksione apo gjilpëra.

Zbulimi i hershëm dhe intervenimi me kohë i prindërve, familjes, shkollës dhe shoqërisë krijon mundësinë e parandalimit të këtyre dukurive . Për çdo rast të dyshimtë të sjelljeve të fëmijëve, prindërit, shkolla, komuniteti, duhet të drejtohen te institucionet përkatëse për trajtim dhe rehabilitim të drogave apo narkomanisë, në qendrat e shëndetit mendor në bashkësi, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës , Klinikën e Psikiatrisë, OJQ "Labyrinth".



## E rëndësishme për mësimdhënësit

Shpeshherë, për arsye parimore, nxënësit nuk janë të motivuar t'i diskutojnë temat që lidhen me përdorimin e substancave. Disa mund të besojnë që vetë diskutimi për këto substanca, qoftë edhe në klasë, mund t'i motivojë njerëzit që të fillojnë t'i përdorin ato. Të tjerët mund të thonë që vetë të mësuarit për këto substanca nuk ka ndonjë rëndësi për nxënësit, sepse gjithsesi ata nuk do t'i përdorin ato.

Para se ta filloni orën mësimore rreth substancave, ju mund ta bëni një listë të atyre që janë të interesuar për t'i ndjekur ato, dhe të atyre që nuk janë të interesuar, duke i bashkëngjitur edhe arsyet e tyre. Bazuar në deklaratat e tyre, ju mund të provoni t'i trajtoni dhe t'ju jepni rëndësi të gjitha këtyre arsyetimeve.

E rëndësishme për të gjithë është kërkimi i zgjedhjes që do t'i mbajë fëmijët tanë të shëndoshë, të lumtur dhe larg nga droga, duhani e alkooli.

## Dhuna

Dhuna në shkollë ul motivin për punë, cilësinë e procesit mësimor, si dhe prodhon efekte të mëtejme të dhunës dhe elemente të tjera negative, që dëmtojnë zhvillimin fizik dhe intelektual të fëmijëve dhe të rinjve. Shi për këtë arsye, dhuna është e sanksionuar me legjislacionin vendor bazuar në instrumentet ndërkombëtare (konventat), prandaj brenda institucionit arsimor, secili individ duhet t'i kontribuojë procesit të parandalimit dhe reagimit të dhunshëm, duke siguruar që stafi udhëheqës, ai arsimor, nxënësit dhe personeli tjetër të promovojnë sjellje të shëndosha, relacione korrekte ndërpersonale dhe kolektive, të cilat çojnë në rezultatet e duhura edukativo-arsimore që priten nga të gjithë: komuniteti shkollor, komuniteti i prindërve dhe e gjithë shoqëria.

Ndonëse, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e sanksionon dhunën në institucionet arsimore me infrastrukturë ligjore, bazuar në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës/njeriut, por edhe kurrikulat dhe politikat arsimore që promovojnë ambiente mike, të shëndetshme dhe të sigurta për të gjithë brenda institucioneve arsimore, prapëseprapë shkollat tona dhe realiteti ynë po përballen me probleme që bien ndesh me synimet tona për t'i arritur standardet për një shoqëri me vlera të qytetërimit demokratik.

Hulumtimet e ndryshme nëpër vite flasin për situatën jo të mirë për sa i përket aspekteve të sigurisë dhe dhunës, gjë që e dëshmojnë raportet statistikore të policisë dhe inspektoratit arsimor (për arsye të jetëgjatësisë së doracakut, nuk po i ofrojmë të publikuara statistikat).

**Sipas hulumtimeve, rezultateve të projekteve të shumta dhe realitetit që e ndiejmë në çdo hap, faktorët që ndikojnë në dhunën në shkolla dhe pasigurinë janë si në vijim:**

**Faktorët individualë** (dija, qëndrimet, mendimet për dhunën dhe mangësitë e aftësive (aftësitë e kufizuara të komunikimit, përdorimi i drogës dhe alkoolit, qenia dëshmitar i dhunës apo të qenit viktimë e dhunës ndërpersonale, qasja ndaj armëve të zjarrit dhe armëve të tjera.);

**Faktorët që rrjedhin nga familja** (mungesa e dashurisë dhe e mbështetjes prindërore; përvoja me dhunën në shtëpi; dënimi fizik dhe keqtrajtimi i fëmijëve; prindërit dhe vëllezërit e motrat të përfshirë në sjellje kriminale.);

**Faktorët shoqërorë** (pabarazia shoqërore-ekonomike, urbanizmi dhe mbipopullimi; transicioni, shoqëruar me nivel të lartë të papunësisë në mesin e të rinjve; ndikimet e mjeteve të informimit publik; normat shoqërore që përkrahin sjellje të dhunshme; disponueshmëria e armëve; situata e pasluftës në Kosovë). Ndërkaq, në mënyrë të veçantë, sa i përket faktorit shkollë janë evidentuar mangësi në respektimin e ligjit, rregullave shkollore, kodit të mirësjelljes, udhëzimeve administrative që e rregullojnë funksionimin e sistemit të arsimit dhe krijimin e raporteve të shëndosha në relacionin nxënës-arsimtar, nxënës-nxënës, udhëheqës-arsimtar dhe prind-arsimtar.

**Sa i përket faktorit ekonomik**, janë relevante për t'u trajtuar edhe shifrat e numrit të nxënësve që vijnë nga familjet me asistencë sociale, por edhe ata pa prindër, sepse mund të jenë në predispozitë për të rënë pre e rreziqeve nga dukuritë e ndryshme.

Duke mos e pasur përkujdesjen e duhur familjare dhe të ndikuar nga rrethanat socio-ekonomike, shumë fëmijëve u imponohet të kërkojnë punë për ta mbajtur veten dhe familjet e tyre, ashtu që rrezikohen të përfshihen në rrjete dhe rrethana të pasigurta dhe të pafavorshme për zhvillimin e tyre fizik dhe intelektual. Mirëpo, nga këto rrethana nuk përjashtohen edhe rastet e fëmijëve e të rinjve me pozita të larta ekonomike, por që nuk e kanë kujdesin e mjaftueshëm prindëror.

## Faktorët e tjerë:

Mbiipopullimi i shkollave, ku punohet në më shumë ndërrime, e që janë kryesisht shkollat në qytetet e mëdha, ku po ndodhin rastet e incidenteve (rastet e këtij fillim viti 2014 përfunduar edhe me fatalitet). Po ashtu klasat e mbingarkuara me nxënës mund të jenë faktor për aktivitetet të dhunshme, etj.

Përdorimi i internetit pa kritere, rrjetet sociale, videolujërat dhe mediet, veçmas televizioni, ku shfaqen filma të dhunshëm dhe programe pa kritere të caktuara për moshat, ndikojnë në aspektin psikologjik të fëmijëve.

## Përkufizimi i dhunës:

“**Dhunë**” nënkupton: “Të gjitha format fizike dhe/ose emocionale të keqtrajtimit, shpërdorimit seksual, neglizhencës apo trajtimit neglizhent, shfrytëzimit komercial ose çdo lloj shfrytëzimi që ka si rezultat dëmtimin e mundshëm apo të vërtetë të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit apo të dinjitetit të fëmijës në kontekst të raportit të përgjegjesisë, besimit, apo forcës”.

**“Dhuna”** përfshin, por nuk kufizohet në veprat apo veprimet e qëllimshme që ia bëjnë një person personit tjetër, si: përdorimi i forcës fizike, presioni psikik, çdo veprim që shkakton apo kanos dhembjen fizike dhe psikike; shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale, cenimit të dinjitetit; sulmi fizik, pa marrë parasysh pasojat; ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë; përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër; vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike.

Llojet e dhunës: dhuna fizike, dhuna verbale, keqtrajtimi, neglizhimi, ngacmimi në mes të bashkëmoshatarëve, dhuna seksuale, abuzimi seksual, shfrytëzimi seksual komercial, dhuna digjitale, dhuna emocionale /psikologjike.

## Përkufizimet e llojeve të dhunës, bazuar në legjislacionin në fuqi

**1.1. “Dhuna ndaj fëmijës”**- nënkupton: “Të gjitha format fizike dhe/ose emocionale të keqtrajtimit, shpërdorimit seksual, neglizhencës apo trajtimit neglizhent, shfrytëzimit komercial ose çdo lloj shfrytëzimi që ka si rezultat dëmtimin e mundshëm apo të vërtetë të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit apo të dinjitetit të fëmijës në kontekst të raportit të përgjegjësisë, besimit, apo forcës”.

**1.2. “Dhuna”- përfshin**, por nuk kufizohet në veprat apo veprimet e qëllimshme që ia bëjnë një person personit tjetër, si: përdorimi i forcës fizike, presioni psikik, çdo veprim që shkakton apo kanos dhembjen fizike dhe psikike; shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale, cenimit të dinjitetit; sulmi fizik, pa marrë parasysh pasojat; ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë; përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër; vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike.

**1.3. “Dhuna fizike”**- nënkupton çdo formë të abuzimit fizik duke përfshirë këtu rrahjen me çfarëdo mjeti, goditje me shuplakë apo edhe me mjete të tjera, shtrëngimin e fytyrës dhe çdo veprim tjetër që shkakton dhimbje fizike.

**1.4. “Dhunë verbale”**- nënkupton përdorimin e fjalëve që shkaktojnë dëm për personin duke folur për të. Me dhunë verbale nënkuptohet: britma, fyerja, kërcënimi, frikësimi, turpërimi, poshtërimi, përdorimi i gjuhës nënçmuese në mesin e formave të komunikimit. Dhuna verbale është edhe deklarata negative për personin ose në lidhje me personin.

**1.5. “Keqtrajtimi”** - nënkupton të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimin seksual, neglizhimin ose trajtimin neglizhues apo shfrytëzimin tregtar ose çdo shfrytëzim tjetër që çon në dëmtim real ose të mundshëm të shëndetit të fëmijës, të mbijetesës, zhvillimit ose dinjitetit në kontekstin e një marrëdhënieje përgjegjësie, besimi ose pushteti.

**1.6. “Neglizhimi”**— nënkupton mospajtimin nga prindi ose kujdestari ligjor i kushteve për zhvillimin e fëmijës kur prindi apo kujdestari ka mundësi ta bëjë këtë gjë: në drejtim të shëndetit, arsimit, zhvillimit emocional, ushqyerjes, strehimit dhe të kushteve të sigurta për jetesë, mbështetjen psikologjike, etj., të cilat çojnë në dëmtimin e mirëqenies fizike, psikike, morale e sociale të fëmijës.

**1.7. “Ngacmimi mes bashkëmoshatarëve”** - nënkupton sjelljet agresive dhe të padëshirueshme në mesin e fëmijëve të moshës shkollore që përfshihen në një mosbalancim real apo të perceptuar të pushtetit. Sjellja mund të përsëritet, ose ka potencial të përsëritet me kalimin e kohës.

**1.8. “Dhuna seksuale”** - nënkupton çdo akt seksual, çdo përpjekje për akt seksual, komentet e padëshirueshme seksuale, aktet e trafikimit me qenie njerëzore, ose aktet që drejtohen ndaj seksualitetit të një personi me përdorimin e kërcënimit me ndëshkim nga çdo person, pavarësisht nga marrëdhënia e tij me viktimën, në çdo rrethanë, përfshirë këtu shtëpinë dhe punën, por pa u kufizuar këtu.

**1.9. “Abuzimi seksual”** - nënkupton shprehjen e abuzimit brenda shtëpisë ose familjes, por nuk përjashton edhe rastet e abuzimit nga persona jashtë familjes duke shfrytëzuar përparësitë e pozitës qoftë sociale apo edhe zyrtare për përfitime seksuale nga viktimat e abuzimit.

**1.10. “Shfrytëzim seksual komercial”** - nënkupton detyrimin e viktimës nga persona të caktuar për zhvillimin e aktivitetit seksual. Po ashtu, këtu përfshihen edhe rastet e prostitucionit fëmijëror dhe pornografisë fëmijërore.

**1.11. “Dhuna digjitale”** - nënkupton çfarëdo forme të dërgimit të mesazheve përmes internetit apo telefonisë mobile. Ka për qëllim lëndimin, shqetësimin apo çfarëdo lloj tjetër të dëmtimit të fëmijës, i cili nuk mund të mbrohet nga veprimet e tilla. Shfaqet në formë të video apo mesazheve tekstuale, fotografive apo thirrjeve.

**1.12. “Dhuna emocionale/ psikologjike”** - nënkupton aktet të cilat shkaktojnë, ose kanë mundësi të madhe të shkaktojnë dëm në shëndetin ose në zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose social të fëmijës. Këto akte mund të jenë në kontrollin e prindit ose të një personi i cili ka përgjegjësi, është i besueshëm ose ka pushtet dhe përfshijnë kufizimin e lëvizjeve, talljen, denigrimin, fajësimin, kërcënimin, trembjen, diskriminimin, përqeshjen, ose forma të tjera jofizike të armiqësisë ose të trajtimit refuzues.

Për ta trajtuar me efikasitet problemin e dhunës në shkollë, janë shumë mundësi që duhet t'i ketë parasysh stafi udhëheqës, ai arsimor dhe të gjithë brenda institucionit. Përveç trajtimit të duhur nëpërmjet të kurrikulave dhe procesit të rregullt edukativo-arsimor, duhet të shtohen edhe aktivitetet ekstrakurrikulare si dhe koordinimi me institucionet e tjera përgjegjëse për t'i ndihmuar institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese në tejkalimin e problemeve që ndërlidhen me dhunën. (Shih rregulloren “Protokolli për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar”, nr. 21/2013). Institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese kanë rol të fuqishëm në trajnimin e problematikës së dhunës, duke kultivuar dhe promovuar të fëmijët vlerat e

qytetërimin, sjelljet e shëndosha, shmangien e situatave konfliktuozë si dhe reflektimin e edukatës dhe mirësjelljes adekuate, si në klasë e shkollë, ashtu edhe jashtë: në rrugë, familje dhe shoqëri.

## Keqpërdorimi i teknologjisë informative

Hulumtimet e fundit lidhur me rreziqet në internet, veçanërisht hulumtimi “Vlerësimi i përdorimit të internetit, rreziku dhe siguria në mesin e fëmijëve 9-16 vjeç në Kosovë” i bërë nga FIT (Qendra për Studime të Avancuara) ofron disa fakte/ rezultate mjaft shqetësuese përsa i përket përdorimit të internetit nga fëmijët, si në vijim:

- **Fëmijët në Kosovë prijnë me llogari në rrjetet sociale me 84 %, krahasuar me shtetet e Evropës, ku të gjitha kanë përqindje nën 80 %.**
- **38 % e fëmijëve kanë deklaruar se kanë parë përmbajtje pornografike në 12 muajt e fundit, prej të cilëve 20% kanë parë çdo ditë ose gati çdo ditë.**
- **42 % e fëmijëve kanë deklaruar që përmbajtja pornografike që e kanë parë në internet i ka shqetësuar ata.**
- **13 % e fëmijëve të moshës 12 vjeçare i kanë mbi 1000 shokë në Facebook ose Twitter dhe 15 % e fëmijëve të moshës 13 vjeçare.**
- **58 % e fëmijëve të anketuar kanë kontaktuar persona të panjohur përmes internetit, 69 % janë takuar edhe personalisht me këta persona.**
- **48 % e fëmijëve janë shqetësuar pas takimeve me persona të panjohur dhe 61 % e fëmijëve tregojnë që janë takuar me meshkuj.**
- **74.2 % e fëmijëve që e përdorin internetin e shfrytëzojnë atë për Facebook, 70 % për muzikë, 58.9 % për Youtube, 45.8 % për lojëra të ndryshme, 22.1 % për Instagram etj.**

Interneti është burim i avancuar me spektër të gjerë informacionesh dhe mundësish për zhvillim, mirëpo familja dhe institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese duhet të ndikojnë në orientimin e duhur të fëmijëve/ nxënësve në përdorimin e internetit për qëllime edukativo-arsimore, duke synuar zhvillimin e duhur të kapaciteteve të tyre intelektuale, por edhe duke i mbrojtur ata nga rreziqet, dëmtimi i shëndetit dhe i statusit social të tyre.

<sup>2</sup>Hulumtimi është realizuar gjatë muajve shkurt-mars 2014 dhe ka përfshirë 1150 respondentë në komunat: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjilan, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë.

dëshmitarë të kohës, kur fëmijët/nxënësit kohën më të madhe e shpenzojnë në internet për qëllimet e evidentuara në hulumtim, duke minimizuar kohën e leximit të librave shkollorë dhe të tjerë, gjë që rezulton edhe me uljen e rezultateve të arritshmërisë, sidomos te nivelet e arsimit të mesëm. Gjithashtu, ka indikacione të mëdha se keqpërdorimi i teknologjisë informative po prodhon situata konfliktuoze dhe të dhunshme ndërmjet bashkëmoshatarëve, por edhe më gjerë. Shpesh fëmijët dhe adoleshentët nuk janë të vetëdijshëm për veprimet e tyre online dhe pasojat negative psikologjike dhe sociale për ta, familjet e tyre dhe shoqërinë në përgjithësi.

Rreziqet e përdorimit të internetit nga fëmijët, përfshirë: pornografinë, dhunën/ ngacmimet digjitale, takimin me njerëz të panjohur, publikimin e të dhënave personale në profilet e tyre, etj., duhet të trajtohen me kujdes, prandaj hapësira e duhur brenda orëve mësimore dhe aktivitetet shtesë do të jenë në favor të krijimit të një kulture të qëndrueshme dhe profitabile të përdorimit të teknologjisë informative.

## Diskriminimi

Për të kaluar më tej te çështjet relevante për sferën edukativo-arsimore dhe aftësuese, po i japim fillimisht parimet mbi të cilat mbështetet Ligji kundër diskriminimit nr. 2004/3 si dhe përkufizimet relevante.

### Parimet:

I. Parimi i trajtimit të barabartë që nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose statuseve të tjera.

II. Parimi i përfaqësimit të drejtë të të gjithë personave dhe të të gjithë anëtarëve të komuniteteve lidhur me punësim në kuadër të organeve publike në të gjitha nivelet.

III. Parimi i mirëkuptimit dhe tolerancës ndëretnike të qytetarëve të Kosovës.

### Përkufizimet:

**a) Diskriminimi i drejtpërdrejtë** nënkuptohet kur një person trajtohet, është trajtuar, ose do të trajtohet në mënyrë të pabarabartë në krahasim me tjetrin, duke u bazuar në një apo më shumë nga bazat e përkufizuara në parimin I.

<sup>3</sup>Ky ligj është në proces të rishikimit

**b). Diskriminimi i tërthortë** nënkuptohet kur nga bazat e përkruara në parimin I, një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në shikim të parë e vë personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerë, duke u bazuar në një apo më shumë nga bazat që e ndalojnë diskriminim, përveç në rastet kur dispozita e tillë, praktika apo kriteri mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim dhe me mjete legjitime, të domosdoshme për arritjen e qëllimit.

**c). Ngacmimi** konsiderohet diskriminim, brenda kuptimit të parimit I, kur një sjellje kundër dëshirës (që përfshin, por nuk kufizohet në sjellje të natyrës së padëshirueshme seksuale dhe/apo psikologjike) dhe që bazohet në një apo më shumë nga bazat e përkruara në parimin I, e cila ka për qëllim apo ndikim në shkeljen e dinjitetit të personit dhe krijimin e ambientit frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues dhe fyjes, si është përcaktuar nga ai person.

**d). Të udhëzuarit për të diskriminuar** personat e tjerë, sipas bazave të përcaktuara në parimin I, do të konsiderohet diskriminim sipas të njëjtit parim.

**e). Viktimizimi** konsiderohet diskriminim brenda kuptimit të parimit I, dhe i cili konsiderohet se ndodh kur personi përjeton trajtim të hidhur apo pasoja të hidhura si reagim ndaj ankimit apo procedurës, të vëna në lëvizje me qëllim të vënies në jetë të parimit të trajtimit të barabartë ashtu si është definuar në parimin I dhe / ose rastet kur personi i tillë ofron informacione, dëshmi apo ndihmë tjetër në lidhje me ankesën ose procedurën.

**f). Segregacioni** konsiderohet diskriminim brenda kuptimit të parimit I, i cili ndodh në rastet kur një ose disa persona veçohen nga tjerët përmes personave fizikë, juridikë, ose me kombinimin e të dyjave, nga sektori publik, privat apo nga dy sektorët, dhe si i tillë bazohet në njërin ose në disa baza të përmendura në parimin I, përveç në rastet kur veçimi i tillë është në baza të arsyeshme dhe objektive dhe mënyra për arritjen e atij qëllimi është i nevojshëm dhe proporcional.

Edhe legjislati i arsimit dhe përgjithësisht politikat arsimore mbështeten në parimet e mosdiskriminimit, prandaj secili brenda institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese duhet t'i ketë parasysh ato në punën e përditshme. Nxënësit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë në çdo situatë, si në zhvillim, vlerësim, po ashtu edhe në përfshirjen në aktivitete të ndryshme edukativo-arsimore, kulturore dhe rekreative. Gjithashtu, duke iu referuar parimit të pjesëmarrjes dhe atij të barazisë, stafi arsimor duhet të kujdeset që të gjithë nxënësit të mund ta zhvillojnë personalitetin, talentin dhe aftësitë mendore e fizike deri në potencialin e tyre të plotë.

Diskriminimi dhe qasja e pabarabartë, prodhon efekte negative të fëmijët, nxënësit dhe të çdokush, duke favorizuar elementet destruktive, pakënaqësinë, tensionimin, dhunën, rivalitetin etj., të cilat destabilizojnë procesin edukativo-arsimor në dëm të cilësisë dhe progresit të synuar. Trajtimi adekuat i nxënësve dhe të gjithëve në çdo situatë brenda dhe jashtë institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese, mundëson avancimin e rezultateve të mësimdhënies dhe mësimnxënies, gjithëpërfshirjen dhe ndërtimin e relacioneve të shëndosha ndërpersonale dhe ndërkolegiale, të cilat rezultojnë në suksesin e përgjithshëm në çdo relacion.

### 3.4. Përgjegjësitë qytetare në parandalimin dhe reagimin ndaj dukurive negative

Përgjegjësitë qytetare në parandalim dhe reagim ndaj dukurive negative kapin një spektër të gjerë të normave ndërkombëtare, ligjeve vendore dhe akteve nënligjore që sanksionojnë, qoftë përdorimin e substancave narkotike, dhunën, diskriminimin, keqpërdorimin e TIK-ut etj. Bazuar në instrumentet ndërkombëtare dhe ligjet tona në fuqi, secili qytetar ka për obligim të raportojë e të mos heshtë para problemeve që i evidenton, ngase në të kundërtën bën vepër penale. Gjithashtu secili institucion (arsimor, shëndetësor, i mirëqenies sociale, i kulturës, i organeve të rendit etj.) ka përgjegjësi brenda fushëveprimit të vet ligjor në relacion me sektorin e vet, por edhe në koordinim ndërsektorial për ta dhënë kontributin e vet në parandalim dhe reagim ndaj dukurive negative. Institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese që parandalimin e bëjnë nëpërmjet procesit të rregullt mësimor, konsiderohen shtylla kryesore në formimin e një shoqërie të shëndoshë, me vlera demokratike, pa dhunë e e diskriminim dhe larg çdo sjelljeje e dukurie që e dëmtojnë shoqërinë. Duke mos dashur që tekstin ta ngarkojmë me deshifrimin e përgjegjësiave ligjore të secilit institucion, po ua ofrojmë në shtojcë listën e instrumenteve ndërkombëtare dhe ligjeve vendore që i reflektojnë/specifikojnë ato.



## KAPITULLI 4

### 4. Planifikimi i procesit mësimor

#### 4.1 Informata të përgjithshme për planifikim

Për të pasur mësimdhënie të suksesshme duhet bërë përgatitjet me kohë. Po ashtu edhe trajtimin e temave që kanë për qëllim përgatitjen e nxënësve, për t'u evituar dhe përballur në mënyrë të drejtë me situatat që cenojnë sigurinë dhe shëndetin e tyre, duhet paraparë që nga planifikimi vjetor, dymujor, javor e deri te ora mësimore. Të gjitha planifikimet duhet të bëhen mbi bazën e rezultateve të kompetencave të shkallës së caktuar. Kështu, së pari duhet identifikuar se cilat rezultate të kompetencave për shkallë kurrikulare mendojmë t'i synojmë në klasën e caktuar, pastaj përcaktojmë fushën kurrikulare (fushën mësimore) dhe identifikojmë rezultatet e saj nga të cilat përcaktojmë temën mësimore. Më pas përcaktojmë lëndën mësimore përmes së cilës trajtojmë temën e planifikuar mësimore dhe i caktojmë rezultatet e kësaj lënde mësimore dhe njësinë mësimore, e cila është në funksion të arritjes së të gjitha rezultateve të planifikuara. Pra bazë e të gjitha llojeve të planifikimeve është kurrikula bërthamë e nivelit të caktuar formal. Gjithashtu mund të përzgjidhen tema edhe në pjesën e aktiviteteve ndërkurrikulare, jashtëkurrikulare, apo të trajtohen te pjesa me zgjedhje, por edhe te secila nga këto duhet bërë planifikime të niveleve të cilat tashmë i numëruam më lart.

#### 4.2 Përgatitjet për orën mësimore

Për të pasur mësimdhënie të suksesshme për secilën temë mësimore, e në këtë rast edhe për temat që trajtojnë rrezikshmërinë e nxënësve, të shkaktuara nga faktori njeri, së pari duhet t'ia bëjmë disa pyetje vetes:

- Cila është audienca për të cilën do ta zhvilloj mësimin?
- Pse është e nevojshme ta trajtoj me ta këtë temë / njësi mësimore?
- Ç' është e nevojshme të dinë ata (çfarë njohuri akademike duhet ofruar)?
- Çfarë shkathësi, qëndrime dhe vlera duhet synuar t'i zhvilloj te ta?
- Si duhet zhvilluar ato (çfarë metodologjie të përdor)?
- Si t'u qasem atyre (të fillohet nga e afërta apo nga e largëta)?
- Çfarë mjete duhet përdorur?
- Ku do ta zhvillojmë orën mësimore?
- Si ta organizoj mjedisin ku do ta elaboroj temën/njësinë e caktuar mësimore?

Pasi t'i kemi definuar qartë përgjigjet në këto pyetje, atëherë i bëjmë përgatitjet për orën mësimore.

Nëse për audiencë kemi nxënës të shkollës fillore, e që mund të jenë nxënës nga klasa parafillore e deri në klasën e pestë, atëherë edhe qasja e trajtimit të këtyre temave duhet bëhet konform moshës së tyre. Aktivitetet të cilat realizohen me ta duhet të jenë të shkurtra dhe të larmishme, në mënyrë që secilit t'i jepet rast të nxë (mësojë) mbi bazën e stileve, metodave që secilit u përshtaten më shumë, sepse disa nxënës mësojnë më shumë në mënyrë vizuale, pra duke i parë vizatimet, fotografitë, ngjarjet, filmat, disa në mënyrë auditive - duke i dëgjuar ngjarjet, disa duke u angazhuar vetë, disa duke bashkëpunuar me të tjerët, etj. Preferohet që aktivitetet në këtë moshë të zhvillohen më shumë në formë të lojës, sepse ata nuk kanë durim të dëgjojnë ligjëratat klasike.

Edhe nëse për audiencë mund të kemi nxënës të shkollës së mesme të ulët apo të shkollë së mesme të lartë, trajtimin e çfarëdo teme çdoherë duhet elaboruar përmes aktiviteteve, metodave të ndryshme, sepse edhe këta nxënës, edhe pse më të rritur, ata tashmë i kanë krijuar stilet e veta të të nxënës dhe mësimdhënësia përmes metodave të ndryshme u jep atyre shanse të barabarta në të nxënë. Preferohet që pas ligjëratave klasike të përdoren edhe metodologji të cilat nxisin të menduarit e pavarur, dhe u mundësojnë atyre të bëjnë analiza, gjykime dhe të nxjerrin përfundime për çështje të caktuara. Andaj, debatet brenda një ore mësimore, loja me role, puna në grupe, dhe shumë metodologji si këto, do të jenë më atraktive dhe në funksion të zhvillimit të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave, respektivisht kompetencave të cilat tashmë i kemi planifikuar.

Gjithashtu përdorimi i një fotografie adekuate, shikimi i një filmi, apo pjesëmarrja e një mysafiri që do ta trajtojë një ngjarje a temë të caktuar, do të jenë më shumë produktive sesa një orë mësimore ku përdoret libri si burim i vetëm i të nxënës (i të mësuarit).

## 4.3 Si realizohet një orë mësimore?

Pasi t'i kemi bërë përgatitjet, atëherë edhe mund ta mbajmë orën mësimore.

Është mirë që në fillim të orës mësimore nxënësit t'i njoftojmë me rezultatet e të nxënës dhe bashkërisht t'i caktojmë kriteret e suksesit të cilat na ndihmojnë të dimë saktësisht gjatë pjesëve të ndryshme të orës se a jemi në drejtim të arritjes së rezultateve që i kemi përcaktuar në fillim të orës. Shih disa shembuj të shkrimit të disa kriterëve të suksesit.

### Nxënësi:

Definon tri institucione ku do t'i raportojë rastet e dhunës. Shkruan saktë një ankesë sipas elementeve të cilat duhet t'i përmbajë ajo.

Brenda orës mund të caktohen dy-tri kriteret e suksesit. Para se të fillohet me elaborimin e njësisë mësimore, është mirë që nxënësit të motivohen për mësim. Motivimi mund të bëhet me një foto, këngë, dëgjim të një ngjarjeje, pjesë të një filmi, lojë etj. nga e cila nxitet debati.

Më pas mund të vazhdohet me ndonjë ligjëratë, sqarim apo ndonjë aktivitet pune e cila punohet mbi detyrën e dhënë. Aktiviteti mund të jetë krahasim i ndonjë materiali, analiza e ndonjë ngjarje nga gazetatat, nga fletushkat mbi të drejtat e njeriut, apo mund të bëhet një poster, mund të përgatitet një fushatë, mund të përgatitet një peticion etj. Pra aktivitete të cilat vetë nxënësit marrin iniciativë për ndryshim në të mirë të secilit, etj.

Ora mund të përfundojë me një lojë, me prezantim të grupeve, me përgjigje në pyetjet, me lexim të ndonjë eseje a mesazhi dhe me shumë e shumë aktivitete të ndryshme.

Nga gjithë kjo mund të konkludojmë se zhvillimi i një ore atraktive bën që sukcesi të jetë arritur.

## KAPITULLI 5

### 5.0 Modele të orëve mësimore

#### 5.1. Tema: Adoleshenca

##### Njësia nr. 1

#### Kompetencat e synuara:

Përmes kësaj teme synohet të arrihen elementet e kompetencave: komunikues efektiv, mendimtar kreativ, nxënës i suksesshëm, kontribues produktiv, individ i shëndoshë dhe qytetar i përgjegjshëm, konkretisht rezultatet: I.2, 4, 8; II.1, 3, 4, 5, 6, 7, 8; III.1, 3, 5, 7; IV. 1, 6, 7, 8; V. 6, 7; VI. 1, 3, 4, 5, 6, 7, 8 të shkallës së pestë të kurrikulës bërthamë (shih KB e arsimit të mesëm të ulët faqe 22-27).

#### Qëllimi:

Një e më shumë orë dhe aktivitete mësimore dedikuar adoleshencës, kanë për qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve për parandalimin e sjelljeve delikvente, si dhe të çdo elementi apo devijimi që e dëmton zhvillimin fizik dhe intelektual të nxënësve.

#### Rezultatet e të nxënit

Përmes trajtimit të kësaj teme, nxënësi:

- Përshkruan karakteristikat e fazës së adoleshencës,
- identifikon rreziqet e përfshirjes së të rinjve në dukuri negative gjatë fazës së adoleshencës,
- vlerëson rolin e institucioneve relevante në parandalim dhe trajtim efikas të rasteve brenda dhe jashtë shkollës.

#### Përgatitja e mësimdhënësit/es

Metodologjia e mësimdhënies

Mësimdhënësi/ja duhet të organizojë klasën në mënyrë që të gjithë ta kenë vëmendjen gjatë shpjegimit të temës. Nuk ka rëndësi a ndahen nxënësit në grupe apo jo, pasi pjesa kryesore e orës realizohet në formë të ligjërit nga ana e mësimdhënësit/es.

## Faza e parë e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën një sqarim të shkurtër rreth temës së adoleshencës, pastaj përdor teknikën stuhi mendimesh (brainstorming). Kjo teknikë e mësimdhënies e paraqitur në fillim të orës mësimore nxjerr të dhëna fillestare për informacionin që posedojnë nxënësit rreth temës për adoleshencën. Ndërkohë mësimdhënësi/ja i shkruan në tabelë të dhënat e siguruara, të cilat do t'i shërbejnë për orientim.

### Në fazën e dytë të orës mësimore zhvillohet një teknikë ditari dypjesësh:

- Në hapin e parë nxënësit informohen për atë që do të lexojnë dhe që gjatë leximit do të marrin shënime.
- Në hapin e dytë u tregohet që fleta të ndahet në mes me një vijë vertikale ku gjatë leximit në anën e majtë të fushës i shkruajnë citatat e nxjerra nga teksti që kanë lexuar, ndërsa në anën e djathtë shkruhen komentet ku preferohet t'i kenë parasysh këto pyetje p.sh. Pse jemi përcaktuar për atë citat? Pse na bëri përshtypje ai koment? etj.
- Në hapin e tretë teksti lexohet duke u ndaluar, për ta shkruar së paku katër herë deri në fund.
- Në hapin e katërt, në fund të leximit kërkohen vullnetarë nga 2 apo tre nxënës që t'i japin komentet e tyre, vullnetarët mund të pyeten përse e zgjodhën atë pjesë për ta komentuar, pse u bëri përshtypje, pyetet nëse ka ndonjë nxënës tjetër që ka zgjedhur pjesën e njëjtë dhe arsyeja pse e ka zgjedhur të njëjtën pjesë si shoku i tij.
- Në hapin e pestë mësuesi i jep dy komente të veta, të cilat i ka nxjerrë gjatë leximit të tij.
- Në hapin e gjashtë mund të bëhet leximi i pjesëve duke u ndaluar pas çdo pjese të lexuar për ta plotësuar ditarin apo për ta parashtruar ndonjë pyetje.
- Në hapin e shtatë shtrohen dy-tri pyetje, të cilat mendohet se kanë mbetur pa përgjigje.

## Modeli i një ditari dypjesësh

PYETJE OSE CITATE

PËRGJIGJE OSE KOMENTE

### 1. Adoleshenca

Njihet si fazë e zhvillimit fizik dhe mendor të njeriut, zakonisht e renditur ndërmjet fazës së fëmijërisë dhe pjekurisë ligjore (mosha madhore).

### 2. Karakteristikat e një të riu/reje adoleshent

Moshë kjo e karakterizuar si moshë e bukurisë, e çiltërsisë, e pastërtisë, e zhvillimit, e guximit, dinamizmit dhe shpresave të mëdha, e që ndonjëherë shoqërohet me ndryshime rrënjësore, të cilat kanë të bëjnë jo vetëm me rritjen biologjike, por edhe me zhvillimin mendor, sjelljen, komunikimin etj.

### 3. Rreziqet e mundshme të përfshirjes. Faktorët dominues në fazën e adoleshencës

Por veprimtaria e një grupi të caktuar adoleshentësh në raste të caktuara mund të kalojë në sjellje jonormale. Adoleshentët në të tilla raste mund të shfaqin sjellje që shoqëria i dënon, si: ikja nga orët e mësimit ose nga shkolla, përfshirja në akte të dënueshme, përdorim a trafikimi i lëndëve narkotike etj. Apo sjellje të influencuara nga grupi.

### Zhvillimet kryesore në adoleshencë

Zhvillimi fizik, kognitiv, emocional, etj.

**Në fazën e tretë të orës mësimore**, nxënësve për temën adoleshenca u parashtrohen pyetje të cilave nxënësit i përgjigjen duke shkruar në mënyrë të lirë, dhe nga secili grup lexohet një shkrim i lirë 5 minutash, në mënyrë përmbledhëse.

## Materialet e nevojshme

### **Materialet e nevojshme për realizimin e orës mund të jenë:**

- Fletë A4, lapsa, flipqartë,
- gazetë, revistë dhe pjesë teksti për adoleshencën
- tabela, shkumësi, ngjytës për letër.
- etj.

Mësimdhënësi/ja e merr vetë përsipër herë pas here shtjellimin e temës me qëllim të orientimit të drejtë të debatit të nxënësve kah tema mësimore.

### **Koha e nevojshme për zhvillimin e temës**

Një orë mësimi, me mundësi vazhdimi.

## Zhvillimi I temës

### **Aktiviteti mund të fillohet me shtrimin e pyetjeve si p.sh:**

- Çka kuptoni me nocionin adoleshencë?
- Çka e karakterizon një të ri-re adoleshent-e?
- Cilat janë rreziqet e mundshme të përfshirjes së adoleshentëve në dukuri negative?
- Cilat janë llojet e zhvillimeve kryesore në adoleshencë?
- Cilët janë disa nga faktorët dominues në fazën e adoleshencës?
- Çfarë masash apo mënyra duhet të përdorim për evitimin e dukurive negative te adoleshentët?

## Aktivitete shtesë

Në një aktivitet shtesë në nivel shkolle, mund të organizohen debate më të mëdha, por edhe shfaqje teatrale dhe aktivitete të tjera artistike (ekspozita me punime në ese, pikturë, etj.), sipas zgjedhjes dhe interesimeve të nxënësve dhe mësimdhënësve.

## 5.2. Tema: Rreziqet e përfshirjes së të rinjve në dukuri negative gjatë fazës së adoleshencës

### Njësia nr. 2

#### Kompetencat e synuara:

Përmes kësaj teme synohet të arrihen elementet e kompetencave: Komunikues efektiv, Mendimtar kreativ, Nxënës i suksesshëm, Kontribues produktiv, Individ i shëndoshë dhe Qytetar i përgjegjshëm, konkretisht rezultatet: I.2, 4, 8; II.1, 3, 4, 5, 6, 7, 8; III.1, 3, 5, 7; IV. 1, 6, 7, 8; V. 6, 7; VI. 1, 3, 4, 5, 6, 7, 8 të shkallës së pestë të kurrikulës bërthamë (shih KB e arsimit të mesëm të ulët faqe 22-27).

#### Qëllimi:

Orët mësimore dedikuar rreziqeve të përfshirjes së të rinjve në dukuri negative gjatë fazës së adoleshencës, kanë për qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve për parandalimin e sjelljeve delikuede që e dëmtojnë zhvillimin fizik dhe intelektual të nxënësve.

#### Rezultatet e të nxënit:

Përmes trajtimit të kësaj teme, nxënësi:

- përshkruan gjendjen psikofizike të një të riu gjatë fazës së adoleshencës,
- identifikon rreziqet e përfshirjes së të rinjve në dukuri negative gjatë fazës së adoleshencës,
- vlerëson rolin e shoqërisë, familjes, grupeve të moshatarëve dhe institucioneve në ndikimin e sjelljeve dhe trajtimin e dukurive që lidhen me adoleshencën.

#### Përgatitja e mësimdhënësit/es

**Koha e nevojshme për zhvillimin e temës: Një orë mësimi**

#### **Materialet e nevojshme për realizimin e orës mund të jenë:**

- fletë, lapsa, flipqartë,
- gazetë, revistë dhe pjesë teksti për rreziqet e përfshirjes së të rinjve në dukuri negative gjatë fazës së adoleshencës,
- tabela, shkumësi, ngjithës për letër.
- Letër A4, etj.

Mësimdhënësi/ja e merr vetë përsipër herë pas here shtjellimin e temës me qëllim të orientimit të drejtë të debatit të nxënësve.

## Zhvillimi i temës

### Aktiviteti mund të fillohet me shtrimin e pyetjeve si p.sh:

- Cilat janë rreziqet e mundshme të përfshirjes së adoleshentëve në dukuritë negative?
- Cilët janë disa nga faktorët që ndikojnë në përfshirjen e adoleshentëve në dukuritë negative?
- Cilët janë faktorët pozitivë që ndikojnë në edukimin dhe përkrahjen e adoleshentëve që të mos marrin pjesë në dukuritë negative.
- Çfarë masash apo strategjish duhet të përdorë shkolla dhe institucionet e tjera për evitimin e dukurive negative të adoleshentët?

## Metodologjia e mësimdhënies

### Mësimdhënësi/ja për këtë orë mësimore mund të përdorë tri teknika mësimore:

#### Copëzat e përziera, mësimdhënien e ndërsjellë, tabelën e koncepteve.

**Faza e parë e orës mësimore** – Mësimdhënësi/ja bën një sqarim të shkurtër rreth temës së adoleshencës, pastaj përdor teknikën Copëzat e përziera. Kjo teknikë e mësimdhënies e paraqitur në fillim të orës mësimore mund të zbatohet në këtë mënyrë:

Nxënësve u jepet nga një pjesë teksti apo fjalie që lidhet me rreziqet e përfshirjes së të rinjve në dukuri negative gjatë fazës së adoleshencës, këto pjesë të tekstit apo fjalive duhet të radhiten dhe duke i kompletuar fjalitë dhe tërësinë e tekstit, pra copëzat e përziera përbëjnë një përmbajtje të ndërlidhur por të paradhitur.

#### Në fazën e dytë të orës mësimore zhvillohet teknika Mësimdhënia e ndërsjellë:

- Në hapin e parë, formohen grupe nxënësish me aq anëtarë sa ka pjesë mësimi.
- Në hapin e dytë, mësuesi u jep udhëzime nxënësve se si do të punohet.
- Në hapin e tretë, leximi bëhet me ndalesa pas secilës pjesë.
- Në hapin e katërt, e lexojnë të gjithë anëtarët e grupit pjesën e parë
- Në hapin e pestë, një anëtar i grupit luan rolin e mësuesit, puna e tij i ka tri role: 1-shpjegon kuptimin e pjesës së lexuar, 2-jep përgjigje, dhe sqarime në pyetjet e anëtarëve të grupit, 3-bën pyetje për anëtarët e tjerë të grupit.
- Në hapin e gjashtë, caktohet një anëtar tjetër i grupit si mësues për leximin e radhës.
- Në hapin e shtatë, nga të gjithë anëtarët e grupit lexohet pjesa e dytë me ecurinë e njëjtë si në pjesën e parë.

**Në fazën e tretë të orës mësimore përdoret teknika:** Tabela e koncepteve, ku nxënësve për temën rreziqet e përfshirjes së të rinjve në dukuri negative gjatë fazës së adoleshencës u sqarohet se me anë të kësaj teknike do ta përpunojnë përmbajtjen me tri e më shumë kategori të cilat mund të krahasohen.

- Në hapin e parë, nxënësit udhëzohen nga mësuesi si të formohet tabela, ose mund t'ju jepet nxënësve nga një tabelë e gatshme.



- Në hapin e dytë, në rreshta të tabelës gjërat që duhet të krahasohen e radhiten.
- Në hapin e tretë, në kolona vendosen tiparet që krahasohen.
- Në hapin e katërt, nxënësit duke i shkruar mendimet e veta brenda katrorëve dhe kolonave, bëjnë krahasime.

	LLOJET E RREZIQEVE	LLOJET E PËRKRAHJES	FAKTORËT QË MUND TË KONTRIBUOJNË POZITIVISHT
ADOLESHENTI	Rreziqet e brendshme Rreziqet e jashtme	Këshilla, bashkëpunimi, loja edukative	Familja, shkolla bashkëmoshatarët
ADOLESHENTJA	Psikologjike, fizike, financiare	Aktivitetet sportive, aktivitetet kulturore	Masmediat këshilluesit profesionistë, etj.

## Aktivitete shtesë

Një aktivitet shtesë, në nivel shkolle mund të organizohen debate më të mëdha, dhe aktivitete të tjera artistike, apo intervista dhe anketime sipas zgjedhjes dhe interesimeve të nxënësve dhe mësimeve të tyre.

## 5.3. Tema: Dukuritë negative që dëmtojnë zhvillimin fizik dhe intelektual të të rinjve

### Njësia nr. 3

#### Kompetencat e synuara:

Përmes kësaj teme synohet të arrihen elementet e kompetencave: Komunikues efektiv, Mendimtar kreativ, Nxënës i suksesshëm, Kontribues produktiv, Individ i shëndoshë dhe Qytetar i përgjegjshëm, konkretisht rezultatet: I.2, 4, 8; II.1, 3, 4, 5, 6, 7, 8; III.1, 3, 5, 7; IV. 1, 6, 7, 8; V. 6, 7; VI. 1, 3, 4, 5, 6, 7, 8 të shkallës së pestë të kurrikules bërthamë. (Shih KB e arsimit të mesëm të ulët faqe 22-27).

#### Qëllimi:

Dy e më shumë orë mësimore për dukuritë negative që dëmtojnë zhvillimin fizik dhe intelektual të të rinjve gjatë fazës së adoleshencës, kanë për qëllim parandalimin e sjelljeve delikuede dhe ndërgjegjësimin e nxënësve rreth kujdesit më të mirë për veten dhe shokët e tyre.

## Rezultatet e të nxënimit:

### Përmes trajtimit të kësaj teme, nxënësi:

- Identifikon dukuritë negative që e dëmtojnë zhvillimin fizik dhe intelektual të të rinjve gjatë fazës së adoleshencës,
- Përshkruan llojet e substancave narkotike që paraqesin rrezik për të rinjtë.
- Analizon dhe krahason dukuritë e rrezikshme për shëndetin e adoleshentit-es.

## Përgatitja e mësimeve/ës

### Koha e nevojshme për zhvillimin e temës: Një orë mësimi

### Materialet e nevojshme për realizimin e orës mund të jenë:

- Fletore, lapsa, flipqartë,
- Letër A4, etj.
- Revistë dhe pjesë teksti për dukuritë negative që e dëmtojnë zhvillimin fizik dhe intelektual të të rinjve gjatë fazës së adoleshencës.
- Tabela, shkumësi, ngjites për letër.
- Nëse ka mundësi projektori dhe llaptopi.

## Zhvillimi i temës

### Aktivitetit mund të fillohet me shkrimin e pyetjeve si p.sh:

- Cilat janë rreziqet e mundshme të përfshirjes së adoleshentëve në dukuritë negative?
- Cilët janë disa nga faktorët që ndikojnë në përfshirjen e adoleshentëve në dukuritë negative?
- Cilët janë faktorët pozitivë që ndikojnë në edukimin dhe përkrahjen e adoleshentëve të mos marrin pjesë në dukuritë negative.

## Metodologjia e mësimeve

### Mësimeve/ësja për këtë orë mësimore mund të përdorë tri teknika mësimore:

### Shkrimi i lirë pesëminutësh, ditari trepjesësh, mendo puno në dyshe thuaja grupit.

**Faza e parë e orës mësimore** – Mësimeve/ësja bën një sqarim të shkurtër rreth temës, pastaj përdor teknikën Shkrimi i lirë pesëminutësh. Nxënësit për temën "Dukuritë negative që e dëmtojnë zhvillimin fizik dhe intelektual të të rinjve gjatë fazës së adoleshencës", u parashtrohen pyetje të cilave nxënësit u përgjigjen duke shkruar në mënyrë të lirë, dhe nga secili grup lexohet një shkrim i lirë 5 minutash, në mënyrë përmbledhëse.

## Në fazën e dytë të orës mësimore zhvillohet teknika ditari trepjesësh:

- Në hapin e parë, nxënësit informohen për atë që do të lexojnë dhe që gjatë leximit do të marrin shënime.
- Në hapin e dytë, u tregohet që fleta të ndahet në mes me dy vija vertikale, ku gjatë leximit, në anën e majtë të fushës, i shkruajnë citatet e nxjerra nga teksti që kanë lexuar, ndërsa në anën e mesme shkruhen komentet, ndërsa në anën e djathtë të fushës shënohen argumentet.

### **Nxënësit preferohet t'i kenë parasysh këto pyetje p.sh. Përse jemi përcaktuar për atë citat? Përse na bëri përshtypje ai koment? Si do ta argumentoj? etj.**

- Në hapin e tretë, teksti lexohet duke u ndaluar, për ta shkruar së paku katër herë deri në fund.
  - Në hapin e katërt, në fund të leximit, kërkohen vullnetarë nga 2 apo 3 nxënës që t'i japin komentet e tyre. Vullnetarët mund të pyeten përse e përzgjedhën atë pjesë për ta komentuar, përse ju bëri përshtypje. Pyetet nëse ka ndonjë nxënës tjetër që e ka zgjedhur pjesën e njëjtë dhe arsyeja pse e ka zgjedhur të njëjtën pjesë si shoku i tij.
  - Në hapin e pestë, mësuesi i jep dy komente të veta, të cilat i ka nxjerrë gjatë leximit të tij.
  - Në hapin e gjashtë, mund të bëhet leximi i pjesëve duke u ndalur pas çdo pjese të lexuar për ta plotësuar ditarin, apo për të parashtruar ndonjë pyetje.
- Në hapin e shtatë, shtrohen dy-tri pyetje, të cilat mendohet se kanë mbetur pa përgjigje

## MODEL I NJË DITARI TREPJESËSH

PYETJA / CITATI	PËRGJIGJE / KOMENTI	PROVA / ARGUMENTI
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Cilat janë rreziqet e mundshme të përfshirjes së adoleshentëve në dukuritë negative?</li> </ul>	<p>Përdorimi i substancave narkotike, dhuna, diskriminimi, keqpërdorimi i teknologjisë informative.</p>	<p>Statistikat, burimet, gazetat, hulumtimet.</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Cilët janë disa nga faktorët që ndikojnë në përfshirjen e adoleshentëve në dukuritë negative?</li> </ul>	<p>Rrethi shoqëror jo i mirë, kujdesi i pamjaftueshëm ndaj të riut, preokupimi me çështje të tjera. Mungesa e kushteve elementare, ndikimi nga grupet negative.</p>	<p>Dëshmi nga mjedisi ku jetojmë.</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Cilët janë faktorët pozitivë që ndikojnë në edukimin dhe përkrahjen e adoleshentëve të mos marrin pjesë në dukuritë negative.</li> </ul>	<p>Familja, moshatarët, shkolla dhe institucionet aktive dhe me mundësi përkrahëse.</p>	<p>Dëshmi nga një nxënës i suksesshëm.</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Çfarë masash apo strategjish duhet të përdorë shkolla dhe institucionet e tjera për evitimin e dukurive negative të adoleshentët?</li> </ul>	<p>Planifikimi, këshillimi, bashkëpunimi reciprok, kryerja e aktiviteteve pozitive për individin dhe shoqërinë.</p>	<p>Planet e veprimit, librat këshillues, aktivitetet përkrahëse etj.</p>

**Në fazën e tretë të orës mësimore, përdoret teknika:****Mendo, puno në dyshe, thuaja grupit, ku nxënësve u kërkohet të bashkohen në dyshe.**

- Në hapin e parë, njëri nxënës nga dyshja e merr përsipër që të shkruajë pesë minuta për temën e lartpërmendur. Ndërsa nxënësi tjetër nga dyshja shkruan për një rast të kundërt me nxënësin afër vete.
- Në hapin e dytë, nxënësit e ndarë në dyshe, pasi të kenë shkruar, i shkëmbejnë përvojat dhe njohuritë e tyre rreth temës.
- Në hapin e tretë, brenda secilit grup një apo dy dyshe, tregojnë se çfarë kanë shkruar dhe komentojnë përvojat e tyre që lidhen me temën.

**Aktivitete shtesë**

Mund të organizohen projekte, apo punime seminarike sipas nivelit të grupmohave në lidhje me temën e caktuar dhe punimi më i mirë nga aspekti strukturor dhe përmbajtësor të shpërblehet me ndonjë dhuratë simbolike si libër, laps, etj.

## 5.4 Tema: Dukuritë negative që dëmtojnë zhvillimin fizik dhe intelektual të të rinjve (Përdorimi i substancave narkotike)

### Njësia nr.4

#### Kompetencat e synuara:

Përmes kësaj teme synohet të arrihen elementet e kompetencave: Komunikues efektiv, Mendimtar kreativ, Nxënës i suksesshëm, Kontribuues produktiv, Individ i shëndoshë dhe Qytetar i përgjegjshëm, konkretisht rezultatet: I.2, 4, 8; II.1, 3, 4, 5, 6, 7, 8; III.1, 3, 5, 7; IV. 1, 6, 7, 8; V. 6, 7; VI. 1, 3, 4, 5, 6, 7, 8 të shkallës së pestë të kurrikulës bërthamë (shih KB e arsimit të mesëm të ulët faqe 22-27).

#### Qëllimi:

Një orë mësimore dhe aktivitete të tjera për substancat narkotike që dëmtojnë zhvillimin fizik dhe intelektual të të rinjve gjatë fazës së adoleshencës, ka për qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve dhe parandalimin e përdorimit duke i njohur karakteristikat dhe pasojat e tyre.

#### Rezultatet e të nxënit

##### Përmes trajtimit të kësaj teme, nxënësi:

- Përshkruan llojet e substancave të dëmshme për zhvillimin fizik dhe intelektual të të rinjve gjatë fazës së adoleshencës.
- Analizon dhe kategorizon llojet e substancave që paraqesin rrezik për të rinjtë.
- Vlerëson rëndësinë e masave për parandalimin e dukurive negative.

#### Përgatitja e mësimeve/ës

##### Koha e nevojshme për zhvillimin e temës: Një orë mësimi

##### Materialet e nevojshme për realizimin e orës mund të jenë:

- Letër A4, etj.
- Fletore, lapsa, flipqartë.
- Revistë dhe pjesë teksti për dukuritë negative që e dëmtojnë zhvillimin fizik dhe intelektual të të rinjve gjatë fazës së adoleshencës.
- Tabela, shkumësi, ngjitës për letër.

## Zhvillimi i temës

### Aktiviteti mund të fillohet me shtrimin e pyetjeve si p.sh:

- Cilat janë llojet e substancave të rrezikshme për shëndetin fizik dhe intelektual?
- Cilat janë efektet negative të cilat vijnë si rezultat i përdorimit të substancave narkotike, duhanit dhe alkoolit?
- Cilët janë faktorët për mbrojtjen e të rinjve nga substancat, duhani dhe alkooli?

## Metodologjia e mësimdhënies

**Faza e parë e orës mësimore** - Mësimdhënësi/ja bën një sqarim të shkurtër rreth temës, pastaj përdor teknikën stuhi mendimesh. Gjatë kësaj pjese mësimdhënësi bën pyetje, ndërsa nxënësit përgjigjen për temën në fjalë. Fillimisht nxënësit japin përgjigje individuale, më vonë i bashkojnë idetë e tyre në çifte e në grup, ndërsa përgjigjet mund të merren në formë frontale.

**Në fazën e dytë të orës mësimore:** zhvillohet teknika diskuto përmes shqyrtimit të përbashkët. Qëllimi i përdorimit të kësaj teknike ka nxitjen e nxënësve të diskutojnë për temën e përcaktuar gjatë një ore mësimore.

- Në hapin e parë, në dërrasë formohet një skemë që i përgjigjet ulëseve të nxënësve, aty shkruhen përgjigjet e nxënësve shkurtimisht. Kjo skemë paraqet angazhimin e nxënësve të angazhuar gjatë diskutimit, por qëllimi tregohet kah fundi i diskutimit.
- Në hapin e dytë, nga mësuesi bëhet një pyetje, ndërsa nxënësit për dy minuta shkruajnë përgjigjen individualisht.
- Në hapin e tretë, nxënësi jep përgjigje.
- Në hapin e katërt, nxënësit i argumentojnë përgjigjet e tyre.
- Në hapin e pestë, argumentet që dalin nga nxënësit përsëriten herë pas here dhe kështu vazhdohet me pyetjet e tjera të radhës.

**Në fazën e tretë të orës mësimore** përdoret teknika **Rrjeti i diskutimeve**, ku shkruhet një pyetje në dërrasë të zezë me mundësi të përgjigjes Po ose Jo.

**Në hapin e parë**, nxënësit e ndarë në dyshe bëjnë ndarjen e fletës në dy pjesë, majtas shënojnë Po, djathtas shënojnë Jo.

**Në hapin e dytë**, në pjesën ku është shkruar Po, renditen përgjigjet dhe argumentet pse është e nevojshme për gjetjen e mundësive që dukuritë negative të evitohen, zvogëlohen dhe parandalohen. Ndërsa në pjesën Jo, renditen përgjigjet, argumentet dhe arsyt, përse nuk duhet të merren masa.

**Në hapin e tretë**, nxënësit e ndarë në dyshe bashkëpunojnë me nxënësit e ndarë në dyshe të tjera. Diskutojnë dhe shtojnë arsye të reja në listë.

**Në hapin e katërt**, nxënësit formojnë tri grupe në tri kënde të klasës:

Grupi për Po, Grupi për Jo, Grupi i pavarësuar. Nxënësit që i takojnë grupit Po dhe grupit Jo, diskutojnë për të përgatitur argumentet e tyre dhe mbajnë qëndrimet e tyre.

**Në hapin e pestë,** secili nxënës që është përzgjedhur si udhëheqës i grupit, për tre minuta jep argumentet e grupit.

**Në hapin e gjashtë,** në mes anëtarëve të grupeve bëhet një debat, ku në mund të përfshihen edhe anëtarët e grupit të pavendosur.

**Në hapin e shtatë,** nxënësit, të cilët kanë arritur t'i ndërrojnë bindjet apo qëndrimet e tyre, mund t'i ndërrojnë grupet e tyre.

**Në hapin e tetë,** nga secili grup del nga një nxënës i cili në mënyrë përmbledhëse do t'i shprehë qëndrimet e grupit.

## Aktivitetet shtesë

Mund të organizohen debate në nivel shkolle dhe ndër shkolla për substancat narkotike, shkaqet, pasojat dhe mënyrën e evitimit të dukurive negative.

### 5.5. Tema: Dhuna, përkufizimi dhe llojet e saj

#### Njësia nr.5

#### Kompetencat e synuara:

Përmes kësaj teme synohet të arrihen elementet e kompetencave: Komunikues efektiv, Mendimtar kreativ, Nxënës i suksesshëm, Kontribues produktiv, Individ i shëndoshë dhe Qytetar i përgjegjshëm, konkretisht rezultatet: I.2, 4, 8; II.1, 3, 4, 5, 6, 7, 8; III.1, 3, 5, 7; IV. 1, 6, 7, 8; V. 6, 7; VI. 1, 3, 4, 5, 6, 7, 8 të shkallës së pestë të kurrikulës bërthamë. (Shih KB e arsimit të mesëm të ulët, faqe 22-27).

#### Qëllimi:

Një orë mësimore dhe aktivitetet shtesë që organizohen në temën: Dhuna, përkufizimi dhe llojet e saj ka për qëllim që duke njohur karakteristikat, format dhe shkaqet e dhunës, të rinjtë të gjejnë mënyra të tjera edukative për parandalimin e përdorimit të dhunës në shkollë dhe vende të tjera ku jetojnë ata.

#### Rezultatet e të nxënës

##### Përmes trajtimit të kësaj teme, nxënësi:

- Përshkruan ç'është dhuna?
- Identifikon faktorët e dhunës
- Përkufizon specifikat e dhunës
- Analizon llojet e ndryshme të dhunës.

## Përgatitja e mësimdhënësit/es

**Koha e nevojshme për zhvillimin e temës: Një orë mësimi**

**Materialet e nevojshme për realizimin e orës mund të jenë:**

- Fletore, lapsa, flipqartë
- Letër A4, etj.
- Revistë dhe pjesë teksti për dhunën dhe pasojat e saj te individi
- abela, shkumësi, ngjites për letër.

## Zhvillimi i temës

**Aktiviteti mund të fillojë me shtrimin e pyetjeve si p.sh:**

- Ç'është dhuna?
- Cilët janë faktorët që ndikojnë në përhapjen e dhunës?
- Si përkufizohet dhuna?
- Cilat janë llojet e dhunës?
- Cilat janë pasojat fizike dhe intelektuale të dhunës te individi?

## Metodologjia e mësimdhënies

**Mësimdhënësi/ja për këtë orë mësimore mund të përdorë tri teknika mësimore:**

**Parashikimi përmes fjalëve kyçe, ruaje fjalën e fundit për mua, ese pesëminutëshe.**

**Faza e parë e orës mësimore** – Mësimdhënësi/ja bën një sqarim të shkurtër rreth temës, pastaj përdor teknikën Parashikimi nëpërmjet fjalëve kyçe.

Në hapin e parë, nga ana e mësimdhënësit caktohen katër terma që përdoren dhe që kanë lidhshmëri me temën e njësisë mësimore, të cilat fjalë nxënësit i ndërlihdhin.

Në hapin e dytë, nxënësit e ndarë në dyshe i lexojnë krijimet e tyre para gjithë klasës.

**Në fazën e dytë të orës mësimore** zhvillohet teknika Ruaje fjalën e fundit për mua.

- Në hapin e parë, nxënësit udhëzohen që gjatë leximit të tekstit të përcaktohen për një, apo më tepër pjesë që atyre u duken më interesante.
- Në hapin e dytë, nga nxënësit kërkohet që pjesët e zgjedhura dhe numri i faqes ku është marrë pjesa të shkruhen në fletore ose fletë A4, ndërsa në anën tjetër të fletës jepet një koment rreth citatit të përzgjedhur.
- Në hapin e tretë, nxënësi tregon faqen ku e ka gjetur pjesën që e lexon, ndërsa të tjerët e përcjellin në libër, apo broshurat gjatë leximit.
- Në hapin e katërt, pas leximit, nxënësit e tjerë diskutojnë rreth citatit të përzgjedhur.
- Në hapin e pestë, nxënësi, pas diskutimit të bërë, lexon komentimin e tij për citatin.
- Në hapin e gjashtë, ecuria e njëjtë e leximit të citatit dhe komentimit praktikohet edhe te nxënësit e tjerë.



Në fazën e tretë të orës mësimore përdoret teknika Ese pesëminutëshe, ku nxënësve u bëhet një pyetje rreth temës së zhvilluar në kuadër të njësisë mësimore. Kësaj pyetjeje nxënësit do t'i përgjigjen duke bërë një ese të argumentuar, të cilat do të lexohen në klasë.

## Aktivite shtesë

Mund të organizohen aktivite apo hulumtime brenda shkollës për të kuptuar përkufizimin e dhunës, faktorëve nxitës, pasojave dhe masat parandaluese.

## 5.6. Tema: Keqpërdorimi i teknologjisë informative dhe diskriminimi

### Njësia nr.6

#### Kompetencat e synuara:

Përmes kësaj teme synohet të arrihen elementet e kompetencave: Komunikues efektiv, Mendimtar kreativ, Nxënës i suksesshëm, Kontribues produktiv, Individ i shëndoshë dhe Qytetar i përgjegjshëm, konkretisht rezultatet: I.2, 4, 8; II.1, 3, 4, 5, 6, 7, 8; III.1, 3, 5, 7; IV. 1, 6, 7, 8; V. 6, 7; VI. 1, 3, 4, 5, 6, 7, 8 të shkallës së pestë të kurrikules bërthamë, (shih KB e arsimit të mesëm të ulët, faqe 22-27).

#### Qëllimi:

Një orë mësimore dhe aktivitetet shtesë që organizohen në temën: Keqpërdorimi i teknologjisë dhe diskriminimi, ka për qëllim t'i parandalojë pasojat, të cilat vijnë si rezultat i diskriminimit ndaj të rinjve dhe keqpërdorimit të teknologjisë.

#### Rezultatet e të nxënësve

##### Përmes trajtimit të kësaj teme, nxënësi:

- Përkshkruan, ç'është teknologjia?
- Identifikon anët pozitive dhe negative të teknologjisë
- Analizon llojet e ndryshme të diskriminimit

#### Përgatitja e mësimeve/ësve

##### Koha e nevojshme për zhvillim të temës: Një orë mësim

Materialet e nevojshme për realizimin e orës mund të jenë:

- Fletore, lapsa, flipqartë,
- Letër A4, etj.

- Revistë dhe pjesë teksti për keqpërdorimin e teknologjisë nga të rinjtë
- Tabela, shkumësi, ngjitës për letër.

## Zhvillimi i temës

**Aktivitetit mund të fillohet me shtrimin e pyetjeve si p.sh:**

- Ç'është teknologjia?
- Si keqpërdoret teknologjia?
- Cilat janë pasojat që vijnë si rezultat i keqpërdorimit të teknologjisë?
- Ç'është diskriminimi?
- Cilat janë llojet e diskriminimit?
- Si evitohen pasojat e diskriminimit ndaj të rinjve?

## Metodologjia e mësimdhënies

**Mësimdhënësi/ja për këtë orë mësimore mund t'i përdorë tri teknika mësimore:**

**Di, Dua të di, Mësova.**

**Faza e parë e orës mësimore** – Mësimdhënësi/ja bën një sqarim të shkurtër rreth temës, pastaj në dërrasë vizaton një tabelë në tri pjesë.

Në hapin e parë, në pjesën e parë, shënohet ajo çka di nxënësi rreth temës në kuadër të njesisë mësimore, dhe fillojnë të pyesin për atë se çfarë duan të dinë.

**Në fazën e dytë të orës mësimore:** zhvillohet njëra nga teknikat Dua të di.

- Në hapin e dytë nxënësit lexojnë tekstin që lidhet me njësinë mësimore dhe pas këtij leximi ata e plotësojnë pjesën e dytë të tabelës.
- Në hapin e tretë, pas leximit, nxënësit pyeten nëse kanë marrë përgjigjet në pyetjet e bëra më herëte cilat janë shënuar në pjesën e tabelës Di.

**Në fazën e tretë të orës mësimore,** përdoret teknika Mësova, nëse nxënësit kanë përgjigje, ato i shkruajnë në pjesën mësoj, apo mësova, ku aty shkruhen edhe informacionet e reja që nxënësit i kanë marrë gjatë leximit.

DI	DUA TË DI	MËSOJ
Shënohen idetë e nxënësve para njohurive. Shënohen edhe pyetjet e nxënësve për temën në fjalë.	Pas leximit të tekstit, plotësojnë pjesën e dytë të tabelës. Nxënësit pas leximit, pyeten nëse kanë gjetur përgjigje në pyetjet e bëra më herët.	Të gjeturat shënohen në pjesën e tretë të tabelës, në këtë pjesë shkruhen edhe informacionet e reja që nxënësit i kanë mësuar gjatë leximit të pjesës së tekstit.

## Aktivitetet shtesë

Mund të organizohen aktivitete në formë debati brenda shkollës nga organizata e rinisë shkollore në bashkëpunim me mësuesit e shkollës

### KAPITULLI 6


## Modul trajnimi mbi dukuritë negative

Programi, mjetet, format e punës dhe metodologjia

### 6.1. Programi i trajnimit të mësuesve në parandalimin e dukurive negative në shkollat e mesme të larta

Modulet	Përmbajtja kryesore	Ditët e trajnimit	Ditët e monitorimit	Punëtoritë për prezantimin e detyrave praktike
Moduli 1				
Moduli 2				
Moduli 3				

#### 6.1.1 Aspektet kryesore të listës së kontrollit që ndihmojnë kryetrajnerët në përgatitje për trajnim

Treguesit për përgatitjen e trajnimit	Shëno përmbushjen e treguesit me 
1. Është përgatitur me kohë lista e pjesëmarrësve, agjenda, materialet dhe fletët shpërndarëse në përkrahje të trajnimit.	
2. Janë planifikuar aktivitete të ekuilibruara si individuale, në çifte dhe në grupe, loja me role, etj.	
3. Janë përgatitur prezantimet dhe janë vendosur në pajisje të TIK-ut për prezantim ose në një formë tjetër	
4. Janë përgatitur pyetjet e nevojshme për të gjitha seancat e trajnimit	

5. Janë përgatitur shembuj nga praktikat shkollore, video, që ndërlidhen me performancën e pritur që duhet të arrihen në fund të seminarit.	
6. Dhoma e trajnimit është përgatitur me radhitje të përshtatshme për realizimin e seancave të trajnimit.	
7. Pajisjet e nevojshme janë vendosur në vendin e duhur dhe janë shfrytëzuar sipas planifikimit.	
8. Materialet ndihmë/ resurset janë vënë me kohë në dispozicion.	
9. Janë marrë parasysh gjatë planifikimit të seancave të trajnimit specifikat e veçanta të temave për trajnim dhe të pjesëmarrësve.	
10. Janë përgatitur instrumentet për vlerësimin e punëtorisë (skeda dalëse, reflektimi individual i pjesëmarrësve etj.).	

**Lista e formave, metodave dhe teknikave të punës, materialeve dhe mjeteve ndihmë vizuale që do të përdoren gjatë trajnimit**

Aspektet kryesore	Moduli 1	Moduli 2	Moduli 3
Puna individuale			
Puna në grupe			
Puna në çifte			
Loja me role			
Pyetjet e kandidatëve			
Punë praktike			
Materiale shtesë nga udhëzuesi			
Punim projekti			
TIK			
Video			
Power Point			
Tabelën e bardhë me letër			
Tjetër (shëno):			
Tjetër (shëno):			

## Metodologjia

Përkufizohet si sistem i strategjive, metodave, mënyrave e parimeve, mjeteve të teknikave, të cilat na shërbejnë si bazë për ndërtimin e konceptit të mësimit.

### Metodat- ecuritë (mënyrat) mësimore

**Metodat e mësimdhënies** janë ecuri organizative me anën e të cilave mësuesi përpqet të realizojë nivelin e dëshiruar të të nxënës dhe rezultatet.

**Metoda** i ka elementet e veta të përhershme: Strategjinë dhe teknikën.

**1. Strategjitë e mësimdhënies janë planifikimi i veprimeve konkrete në klasë sipas kërkesave të një metode të caktuar.**

**2-Teknika ka të bëjë me shprehitë dhe mjetet që përdor mësuesi për t'i realizuar rezultatet e një ore mësimi.**

## Instrumentet e vlerësimit

Vrojtimi (vëzhgimi)

Pyetësori (vetëvlerësimi)

Detyrat

Raporti me shkrim, një punë praktike apo hulumtim

Të shprehurit me gojë (përgjigjet me gojë)

Të shprehurit me shkrim

Prezantimet

Fleta kontrolluese (përdoret për shkathtësitë mësimore, të nxënës)

Esetë dhe punimet e pavarura me projekte.

## Si ta përgatisim modulin?

- Koncepti
- Ecuria e punës
- Modelet eventuale
- Përmbajtja - temat
- Lidhja ndërlëndore – fushat/lëndët
- Si do ta prezantojmë para audiencës?

## Komponentet e modulit

1.Titulli

2.Ngarkesa (orët)

3.Klasa

4. Drejtimi
5. Rezultatet e fushës (lëndës-klasës)
6. Konceptet kryesore
7. Përshkrimi i shkurtër
8. Rezultatet e pritura për modul
9. Përmbajtja – nëntemat dhe aktivitetet e të nxëniet
10. Metodologjia e punës
11. Vlerësimi
12. Literatura/resurset

## Disa koncepte kryesore gjatë përgatitjes së modulit

Fokusi në temë

- I përgjithshëm – bazik – thelbësor – i lirë
- Fleksibiliteti (të nxëniet gjatë gjithë jetës, nevojat e nxënësve)
- Qasje individuale
- Cilësi e lartë dhe synim i qartë
- I orientuar në rezultate
- Transparenca dhe gjithpërfshirja – kurrikula
- Shfrytëzimi i efektshëm i resurseve
- Gara
- Bashkëpunim dhe punë ekipore

## Gjatë punës - të kujtojmë:

- Moduli është temë e veçantë përmbajtësore brenda fushës kurrikulare apo lëndës
- Qasje modulare
- Pikënisje për dizajnim të modulit janë:
- Vlerat e qasjes modulare (shiko konceptet)
- Objektivat e qarta
- Detyra konkrete

## 7. Përfundim

Mësimdhënës të nderuar, temat dhe njësitë mësimore të paraqitura në këtë manual, nuk janë të vetmet që mund ta trajtojnë problematikën e dukurive negative. Dukuritë negative mund të shikohen dhe të analizohen nga perspektiva të shumta, pasi kërkohet qasje shumëdimensionale dhe kontribut ndërsektorial.

Për procesin e rregullt mësimor dhe orët mësimore, Ju mund të zgjidhni edhe tema të tjera sipas relevancës kontekstuale në shkollën dhe rrethin ku punoni. Gjithashtu, temat e tjera të larmishme mund t'i realizoni edhe në nivel të aktiviteteve ekstra-kurrikulare, si: debate, aktivitete garuese, shfaqje teatrale, ekspozita me punime, etj.

.Kësisoj, orët e rregullta mësimore dhe aktivitetet shtesë, që mund t'i ketë shkolla me temat e caktuara, rrisin informacionin te nxënësit dhe ndikojnë në ndërtimin e qëndrimeve adekuate, karshi problemeve që i atakojnë. Një qasje e tillë e punës brenda shkollave promovon sigurinë dhe parandalimin e dukurive negative, si dhe favorizon ambientin për kultivimin e mirëqenies, sigurisë dhe vlerave të qytetërimit demokratik.

## 8. Shtojcë/ burimet e informacionit

<http://www.masht-gov.net>

Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar e Republikës së Kosovës, MASHT, 2012

Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë ( Klasa X, XI, XII), MASHT, 2012

KEC & ARA. (2001.). Leximi shkrimi dhe diskutimi në çdo lëndë, Udhëzuesi 3. Tiranë: KEC & ARA.

KEC & ARA. (2001). Teknika të tjera për zhvillimin e të menduarit kritik, Udhëzuesi 4. Tiranë: KEC & ARA.



### Teknikat

Copëzat e përziera fq.32.

Shkrimi i lirë, fq.32.

Mësimdhënia e ndërsjellë, Fq.36.

Ditari dypjesësh, fq.40.

Ruaje fjalën e fundit për mua, 44.

Ese 5- minutëshe, fq.47.

Tabela e koncepteve, fq.47.

### Teknikat

Parashikimi nëpërmjet fjalëve kyçe, fq.9.

Diskutim përmes shqyrtimit të përbashkët, fq.11

Di, dua të di, mësoj, fq.26

### Rezultatet nga kurrikula bërthamë

Rezultatet e të nxënit për shkallë RNSH. fq.22-33.

Rezultatet e të nxënit të fushës RNF. Fq.70-71.

### Libri

KEC & ARA. (2001.). Leximi shkrimi dhe diskutimi në çdo lëndë, Udhëzuesi 3.

Tiranë: KEC & ARA.

### Libri

KEC & ARA. (2001). Teknika të tjera për zhvillimin e të menduarit kritik, Udhëzuesi 4 . Tiranë: KEC & ARA

### Kurrikula bërthamë

MASHT. (2012). Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë (Klasa X, XI, XII) . Prishtinë: BKUK.









